



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Ministarstva za Obrazovanje
Nauku, Tehnologiju i Inovacia-Ministry of Education Science, Technology and Innovation*

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASHTI) NR. 18 /2023 PËR KËSHILLTARËT
PËR KARRIERË NË IAP**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MESTI) NO. 18 /2023 FOR CAREER
ADVISORS IN PEI**

**ADMINISTRATIVNA UREDBA (MONTI) BR. 18 /2023 ZA SAVETNIKE ZA
KARIJERU U IPOO**

<p>Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Në mbështetje të paragrafit 1 të nenit 37 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 17 / 16 shtator 2011), Prishtinë, paragrafi 3 i nenit 24 të Ligji nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 7 / 26 mars 2013), Prishtinë, nenin 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 34, 18 nëntor 2022 dhe nenin 38, paragrafi 6 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës. nxjerr:</p> <p style="text-align: center;">UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASHTI) NR. ____/2023 PËR KËSHILLTARËT PËR KARRIERË</p> <p style="text-align: center;">Neni 1</p>	<p>The Minister of Education, Science, Technology and Innovation, Pursuant to paragraph 1 of Article 37 of the Law No. 04 / L-032 on Pre-university Education in the Republic of Kosova (Official Gazette of the Republic of Kosova / no. 17 /16 September 2011), Prishtina, paragraph 3 of Article 24 of Law no. 04/L-138 on Vocational and Training Education (Official Gazette of the Republic of Kosova / no. 7/26 March 2013), Prishtina, Article 8, paragraph 1, subparagraph 1.4, Appendix 1, paragraph 7 of the Regulation (GRK) no. 02/2011 on areas of administrative responsibility of the Prime Minister’s Office and Ministries (30. 03. 2021, Administrative instruction no. 03/2013 on the standards for drafting normative acts (OG, no. 03/2013, dated 16.05.2013., issues:</p> <p style="text-align: center;">ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MESTI) NO. ____/2023 FOR CAREER ADVISORS</p> <p style="text-align: center;">Article 1</p>	<p>Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije, U skladu sa stavom 1 član 37 Zakona br. 04/L-032 o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo (Službeni glasnik Republike Kosovo / Br. 17/16 septembar 2011), Priština stav 3 član 24 Zakon br04/L-138 o profesionalnom obrazovanju i osposobljavanju (Službeni glasnik Republike Kosova / Br. 7/26 marta 2013), Priština, član 8 stav 1 podstav 1.4, aneks 1 stav 7 Uredbe (VRK) br. 02/2021 za oblasti administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava dat. 30. 03. 2021, Administrativnog uputstva br. 03/2013 o standardima za izradu normativnih akata (SG , br. 03/2013, dat. 16.05.2013.), izdaje:</p> <p style="text-align: center;">ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MONTI) BR. ____/2023 ZA SAVETNIKE ZA KARIJERNU</p> <p style="text-align: center;">Član 1</p>
---	--	--

Qëllimi	The purpose	Cilj
<p>Ky udhëzim administrativ e rregullon pozitën, funksionin, rolin, mënyrën e financimit, monitorimin dhe vlerësimin e Këshilltarëve për Karrierë në institucionet e arsimit parauniversitar (SHMU, gjimnaze dhe AAP), sipas standardeve të përcaktuara në shtojcat përkatëse të këtij UA.</p>	<p>This administrative instruction regulates the position, function, role, financing method, monitoring and evaluation of Career Advicors in Pre-university Education Institutions (LSSch, gymnasium and VET), according to the standards defined in the respective Anexes of this AI.</p>	<p>Ovo administrativno uputstvo reguliše položaj, funkciju, ulogu, način finansiranja, monitoringa i ocenjivanje savetnika za karijeru u institucijama preduniverzitetskog obrazovanja (NSS, gimnazije i POO), prema standardima definisanim u dodacima ovog AU.</p>
<p align="center">Neni 2 Përkufizimet</p>	<p align="center">Article 2 Definitions</p>	<p align="center">Član 2 Definicije</p>
<ol style="list-style-type: none"> 1. MASHTI - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. 2. AAAPARR - Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve. 3. AAP-Arsimi dhe Aftësimi Profesional. 4. AKK-Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. 5. DKA - Drejtoria Komunale e Arsimit. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. MESTI - Ministry of Education, Science, Technology and Innovation. 2. AVETAE - Agency for Vocational and Training Education and Adult Education. 3. VET - Vocational Education and Training. 4. NQA - National Qualification Authority. 5. MED - Municipality Education Directorate. 6. PEI - Pre-university education institution 	<ol style="list-style-type: none"> 1. MONTI - Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije. 2. APOOOO Agjencia za profesionalno obrazovanje i osposobljavanje i obrazovanje za odrasle 3. POO -Profesionalno obrazovanje i osposobljavanje. 4. NAK - Nacionalni autoritet za kvalifikacije 5. ODO - Opštinski direktorijat za obrazovanje. 6. IPO-Institucije preduniverzitetskog obrazovanja


<p>6. IAP-Institucionet e Arsimit Parauniversitar.</p> <p>7. IAAP - Institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional.</p> <p>8. KK - Këshilltarët për Karrierë.</p> <p>9. KMVP – Koordinatori për mësim në vendin e punës.</p> <p>10. SHMU – Shkollat e Mesme të Ulëta.</p> <p>11. SHML – Shkollat e Mesme të Larta.</p>	<p>7. VETI - Vocational Education and Training Institutions.</p> <p>8. CA - Career Advisors</p> <p>9. WLC - Workplace Learning Coordinator.</p> <p>10. LSSch - Low Secondary School</p> <p>11. HSSch - High Secondary School</p>	<p>7. IPOO - Institucije za profesionalno obrazovanje i osposobljavanje.</p> <p>8. SK - Savetnici za karijeru.</p> <p>9. KURM – Koordinator za učenje na radnom mestu.</p> <p>10. NSŠ– Niže srednje škole</p> <p>11. VSŠ– Više srednje škole</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Roli i Këshilltarëve për Karrierë</p> <p>1. Ndihmon nxënësit e SHMU-ve të marrin vendim të informuar mbi profesionin dhe zhvillimin e karrierës, duke shfrytëzuar potencialin e tyre të plotë për jetë dhe punë.</p> <p>2. Mbështet nxënësit e SHMU-ve dhe gjimnazeve në arritjen e të priturave kurrikulare të lidhura me konceptet e karrierës.</p> <p>3. Mbështet proceset e themelimit të klubit të karrierës me nxënës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Role of Career Advisors</p> <p>1. Helps students of LSSch to make informed decisions about their profession and career development, utilizing their full potential for life and work.</p> <p>2. It supports the students of LSSch and Gymnasiums in achieving curricular expectations related to career concepts.</p> <p>3. Supports processes of establishing career clubs with students.</p> <p>4. It helps LSSch and students improve their knowledge and skills for career development and management to ease their</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Uloga Savetnika za karijeru</p> <p>1. Pomaže učenicima NSŠ i VSŠ - gimnazija da ostvare svoj puni potencijal u životu, obrazujući se u adekvatnom školskom smeru, motivisani i da sazna ponude za školovanje i rad.</p> <p>2. Podržava učenike NSŠ-a i gimnazija u postizanju kurikularnog očekivanja povezanih za konceptima karijere.</p> <p>3. Podržava učenike u osnivanju klubove za karijeru</p> <p>4. Pomaže učenicima SS škola da unaprede svoje znanje i veštine za razvoj upravljanje karijere kako bi olakšali njihov</p>

<p>4. Ndhmon nxënësit e SHML-së t'i përmirësojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre për zhvillim dhe menaxhim të karrierës për ta lehtësuar tranzicionin e tyre nga shkolla në punë dhe edukimin e mëtutjeshëm akademik.</p> <p>5. Informon dhe mbështetë nxënësit e klasave të 9-ta lidhur me vendimmarrjen për profesionin e tyre te ardhshëm.</p> <p>6. Informon dhe mbështetë nxënësit e klasave të 12-ta lidhur me mundësitë e shkollimit të mëtejshëm akademik.</p> <p>7. Informon dhe mbështetë nxënësit që kanë braktisur shkollën dhe të rriturit për orientim dhe zhvillim në karrierë.</p> <p>8. Bashkëpunon me KMVP për përgatitjen e nxënësve të AAP-së me shkathtësitë e buta për realizim të suksesshëm të MVP-së.</p> <p>9. Bashkëpunon me palët e ndryshme të interesit në funksion të orientimit dhe zhvillimit në karrierë të nxënësve dhe të rriturve.</p> <p>10. Promovon, zhvillon dhe zbaton konceptet e këshillimit dhe orientimit në</p>	<p>transition from school to work and further academic education.</p> <p>5. Informs and supports 9th grade students regarding decision-making for their future profession.</p> <p>6. Informs and supports 12th grade students regarding opportunities for further academic education.</p> <p>7. Informs and supports students who have dropped out of school and adults for career guidance and development.</p> <p>8. Collaborates with KMVP to prepare students of VET with soft skills for successful implementation of MVP.</p> <p>9. It cooperates with various stakeholders in the function of orientation and career development of students and adults.</p> <p>10. Promotes, develops, and implements lifelong career counseling and guidance concepts for students/attendees.</p>	<p>prelazak iz škole na posao i dalju akademsku edukaciju.</p> <p>5. Informiše i podržava učenike 9-tog razreda u vezi sa donošenjem odluke za njihovu buduću profesiju.</p> <p>6. Informiše i podržava učenike 12-tog razreda u vezi sa mogućnostima daljeg akademskog školovanja.</p> <p>7. Informiše i podržava učenike koji su napustili školu i odrasle za orijentaciju i razvoj u karijeri.</p> <p>8. Saraduje sa Srednjim stručnim obrazovanjem na pripremi učenika sa mekim veštinama za uspešnu implementaciju URM-a.</p> <p>9. Saraduje sa različitim zainteresovanim stranama u cilju orijentacija i razvoj u karijeri kod odrasle učenike .</p> <p>10. Promoviše, razvija i sprovodi koncepte doživotnog savetovanja o karijeri i vođenja za učenike/sledbenike.</p>
--	--	--

<p>karrierë gjatë gjithë jetës për nxënësit / vijuesit.</p> <p>11. Kontribuojnë në hartimin e politikave vendore për fushën e këshillimit dhe orientimit për karrierë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Funksioni i Këshilltarëve për Karrierë</p> <p>1. Këshilltarët për karrierë janë staf profesional që funksionojnë në kuadër të SHMU-ve, SHML-ve sipas standardeve të përcaktuara në shtojcat përkatëse të këtij UA.</p> <p>2. Këshilltarët për karrierë i propozon institucioni shkollor përkatës dhe i përzgjedhë DKA, respektivisht AAAPARr, sipas standardeve të përcaktuara në shtojcat përkatëse të këtij UA.</p> <p>3. Këshilltarët për Karrierë pajisen me kontratë nga DKA-të, respektivisht AAAPARr, me kohë të pacaktuar sipas standardeve të përcaktuara në shtojcat përkatëse të këtij UA.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Menaxhimi dhe raportimi</p>	<p>11. Contribute to the drafting of local policies in the field of career counseling and guidance.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Function of Career Advisors</p> <p>1. Career advisors are professional staff who work within LSSch, HSSch according to the standards defined in the respective Annexes of this AI.</p> <p>2. Career advisors, are proposed by the relevant school institution and selected by the MED, respectively AVETAE, according to the standards defined in the respective Annexes of this AI.</p> <p>3. Career counselors are provided with a contract by MED, respectively AVETAE, for an indefinite period according to the standards defined in the respective Annexes of this AI.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Management and reporting</p> <p>1. Career advisors report according to the hierarchy in the organizational scheme of the LSSch, and HSSch.</p>	<p>11. Doprinosi izradi lokalnih politika u oblasti karijernog savetovanja i vođenja.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Uloga Savetnika za karijeru</p> <p>1. Savetnici za karijeru su profesionalni staf koje radi u okviru SHMU, SHML (srednjih škola) i IAAP-a prema standardima definisanim u dodacima ovog AU.</p> <p>2. Savetnike za karijeru predlaže relevantna školska institucija, a bira ODO, odnosno APOOOO, prema standardima definisanim u odgovarajućim Prilozima ovog AU.</p> <p>3. Savetnici za karijeru dobijaju ugovor od strane ODO, odnosno APOOOO, na neodređeni period u skladu sa standardima definisanim u dodacima ovog AU.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Upravljanje i izveštavanje</p> <p>1. Savetnici za kraejru izveštavaju prema hijerarhiji u organizacionoj šemi odgovarajućih školskih institucija NSS, VS škola ili ISOO</p>
--	---	---

<p>1. Këshilltarët për Karrierë raportojnë sipas hierarkisë në skemën organizative të SHMU-ve dhe SHML-ve.</p> <p>2. Lidhur me punën e këshilltarëve për karrierë, drejtori i institucionit shkollor përkatës i raporton DKA-së, respektivisht AAAPARr-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Financimi</p> <p>1. DKA-të, respektivisht AAAPARr, janë përgjegjës për sigurimin e pagave të këshilltarëve për karrierë, si dhe mjetet materiale për realizimin e aktiviteteve të tyre.</p> <p>2. DKA-të, respektivisht AAAPARr, janë përgjegjës për kualifikimin dhe zhvillimin profesional të këshilltarëve për karrierë.</p> <p>3. DKA-të, respektivisht AAAPARr, janë përgjegjës për sigurimin e hapësirave të punës dhe pajisjeve për këshilltarët për karrierë me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore për karrierë, sipas standardeve të përcaktuara në shtojcat përkatëse të këtij UA.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Monitorimi dhe vlerësimi</p>	<p>2. Regarding the work of career advisors, the principal of the respective school institution reports to MED, respectively AVETAE.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Funding</p> <p>1. MEDs, respectively AVETAE, are responsible for providing career advisors' salaries, as well as the material means for the realization of their activities.</p> <p>2. MEDs, respectively AVETAE, are responsible for the qualification and professional development of career advisors.</p> <p>3. MEDs, respectively AVETAE, are responsible for providing work spaces and equipment for career advisors in order to provide quality career services, according to the standards defined in the respective annexes of this AI.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Monitoring and Evaluation</p> <p>1. The monitoring and evaluation of Career Advisors is done by the principal of the LSSch and HSSch institutions</p>	<p>2. Što se tiče rada Savetnika za karijeru, direktor odgovarajuće školske institucije izveštava ODO, odnosno ASSO00</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Finansiranje</p> <p>1. ODO, odnosno IPO000, odgovorni su za obezbeđivanje plata Savetnika za karijeru, kao i materijalna sredstva za realizaciju njihovih aktivnosti.</p> <p>1. ODO, odnosno APO000, odgovorni su za kvalifikaciju i profesionalni razvoj Savetnika za karijeru.</p> <p>2. ODO, odnosno APO000, odgovorni su za obezbeđivanje radnog prostora i opreme za Savetnike za karijeru u cilju pružanja kvalitetnih usluga za karijeru, u skladu sa standardima definisanim u odgovarajućim dodacima ovog AU.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Monitoring i ocenjivanje</p> <p>1. Monitoring i ocenjivanje Savetnika za karijeru vrši direktor odgovarajuće</p>
--	--	---

<p>1. Monitorimi dhe vlerësimi i Këshilltarëve për Karrierë bëhet nga drejtori i SHMU-ve dhe SHML-ve sipas standardeve të përcaktuara në shtojcat përkatëse të këtij UA.</p> <p>2. MASHTI e zhvillon udhëzuesin dhe format për monitorim dhe vlerësim të Këshilltarëve për Karrierë sipas standardeve të përcaktuara në shtojcat përkatëse të këtij UA.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Shtojcat e UA</p> <p>1. Pjesë e UA janë:</p> <p>1.1. Shtojca, Standardet për organizimin dhe funksionimin e Këshilltarëve për Karrierë në institucionet e shkollave të mesme të larta (SHML-gjimnaze);</p> <p>1.2. Shtojca, Standardet për organizimin dhe funksionimin e Këshilltarëve për Karrierë në institucionet e shkollave të mesme të ulëta, dhe</p> <p>1.3. Shtojca, Standardet për organizimin dhe funksionimin e Këshilltarëve për Karrierë në</p>	<p>according to the standards defined in the respective annexes of this UA.</p> <p>2. MESTI develops the guide and forms for monitoring and evaluation of Career Advisors according to the standards defined in the respective annexes of this AI.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Appendices of AI</p> <p>1. Part of AI are:</p> <p>1.1. Appendix, Standards for the organization and functioning of Career Advisors in higher secondary school institutions (HSSch – gymnasiums);</p> <p>1.2. Appendix, Standards for the organization and operation of Career Advisors in lower secondary school institutions, and</p> <p>1.3. Appendix, Standards for the organization and functioning of Career Advisors in vocational education and training institutions.</p> <p style="text-align: center;">Article 9</p>	<p>školske institucije Nizeg srednjeg i Viseg srednjeg obrazovanja u skladu sa standardima definisanim u dodacima ovog AU.</p> <p>2. MONTI razvija vodič i način za monitoring i ocenjivanje Savetnika za karijeru u skladu sa standardima definisanim u dodacima ovog AU.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Dodaci AU</p> <p>1. Deo UA su:</p> <p>1.1. Dodatak, Standardi za organizovanje i funkcionisanje savetnika za karijeru u institucijama više srednjih škola (VŠŠ-gimnazije);</p> <p>1.2. Dodatak, Standardi za organizovanje i funkcionisanje savetnika za karijeru u institucijama niže srednjih škola i</p> <p>1.3. Dodatak, Standardi za organizovanje i funkcionisanje savetnika za karijeru u institucijama profesionalnog obrazovanja i osposobljavanja.</p>
--	--	--

Hyrja në fuqi	Entry into force	Hyrja në fuqi
<p>Ky Udhëzim administrativ hyr në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare.</p> <p style="text-align: center;">  Arbërie Nagavci Ministre/MASHTI Me dt. <u>27/09/2023</u> </p>	<p>This Administrative instruction enters into force seven (7) days after the publication in the official gazette.</p> <p style="text-align: center;"> Arbërie Nagavci Minister/ MESTI On: / / </p>	<p>Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana nakon objavljivanja u Službenom glasniku.</p> <p style="text-align: center;"> Arbërie Nagavci Ministarska/MONTI Dana. / / </p>



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit- Ministarstva za Obrazovanje
Nauku, Tehnologiju i Inovacija-Ministry of Education Science, Technology and
Innovation*

**Standardet për organizimin dhe funksionimin e Këshilltarëve për Karrierë në
institucionet e Shkollave të Mesme të Larta (SHML) - Gjimnaze**

Qershor, 2023

Përmbajta

1. HYRJE.....	3
2. ORIENTIMI NË KARRIERË NË GJIMNAZE.....	4
3. STANDARDET MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLTARËVE PËR KARRIERË NË GJIMNAZE	6
Standardi 1 - Misioni dhe objektivat.....	6
Standardi 2 – Roli i Këshilltarëve për Karrierë	8
Standardi 3 – Angazhimi dhe funksionimi i Këshilltarëve për Karrierë në gjimnaze	12
Standardi 4 - Hapësirat dhe pajisjet e nevojshme për punën e Këshilltarëve për Karrierë	15
Standardi 5 - Monitorimi dhe vlerësimi i Këshilltarëve për Karrierë.....	17
4. SHTOJCAT PËR GJIMNAZE.....	1
Shtojca 1. Edukimi për karrierë	1
Shtojca 2. Informacionet dhe burimet për karrierën	3
Shtojca 3. Ngritja e shkathtësive të buta për karrierë dhe punësueshmëri.....	4
Shtojca 4: Përshkrimi i detyrave të Këshilltarëve për Karrierë- Informatë fillestare lidhur me resurset njerëzore	6

Shkurtesat

AAAPARr	Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
CEDEFOP	Qendra Evropiane për Zhvillimin e Formimit Profesional
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
EYE	Rritja e Punësimit për të Rinj
IAEVG	International Association for Education and Vocational Guidance
IAP	Institucionet e Arsimit Parauniversitar
IAAP	Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MVP	Mësimi në Vendin e Punës
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës
QAP	Qendra e Aftësimit Profesional
QeK	Qendra e Kompetencës
KK	Këshilltarët për Karrierë
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve

KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
SHML	Shkollat e Mesme të Larta
SHMU	Shkollat e Mesme të Ulëta

1. HYRJE

Këshillimi dhe orientimi për karrierë, si koncept më i gjerë i cili përfshin: informimin, edukimin, këshillimin, orientimin dhe menaxhimin e karrierës gjatë gjithë jetës, është bërë më i rëndësishëm se asnjëherë më parë. Aktualisht në vendin tonë, por edhe globalisht, po ndodhin shumë ndryshime: transformime digjitale, zhvillim i ekonomisë së gjelbër, përshtetja e ndryshimeve demografike, etj. Si rrjedhojë, individët po navigojnë në një treg pune gjithnjë e më kompleks. Në të njëjtën kohë, realitetet sfidues mbetet papunësia e lartë e të rinjve dhe prezenca e sektorëve të mëdhenj informal. Prandaj, orientimi për karrierë, është kyç për të ndihmuar individët që të përmirësojnë shkathësitë, të rikualifikohen, të zhvendosin vendet e punës dhe të menaxhojnë jetën dhe punën e tyre. Mbështetja për zhvillimin e karrierës është gjithashtu kyç në arritjen e objektivave strategjike në politikat e arsimit, trajnimit dhe punësimit, si dhe në mbështetjen e zhvillimit të shkathtësive sektoriale.

Këshillimi dhe orientimi për karrierë është proces kompleks dhe i vazhdueshëm, i cili zgjat nga ‘*djepi deri në pleqëri*’. Në shekullin tonë, trendet globale po sugjerojnë të kemi ‘zhvillim gjatë tërë jetës si standard’¹.

Qëllimet e këshillimit dhe orientimit për karrierë ndahen në tri kategori kryesore:

- *Qëllimet e të nxënësve*, duke përfshirë përmirësimin e efikasitetit të sistemit arsimor gjithpërfshirës dhe ndërlidhjes së tij me tregun e punës. Nëse individët marrin vendime në bazë të informatave të mira, lidhur me interesat, kapacitetet dhe aspiratat e tyre, investimet në sistemet e arsimit kthehen me përfitime të larta.
- *Qëllimet e tregut të punës*, duke përfshirë përmirësimin e përputhjes ndërmjet ofertës dhe kërkesës dhe menaxhimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve. Nëse njerëzit gjejnë punë që shfrytëzojnë potencialin e tyre dhe përmbushin qëllimet e tyre, ata janë më të motivuar dhe për këtë arsye më produktivë.

¹ IAEVG International Conference 2023 ‘Life long Development as a standard’

- *Qëllimet e barazisë sociale*, duke përfshirë mbështetjen e mundësive të barabarta dhe promovimin e përfshirjes sociale. Shërbimet e këshillimit dhe edukimit për karrierë mund të rrisin aspiratat e grupeve të pafavorizuara dhe t'i mbështesin ata t'i arrijnë mundësitë që përndryshe mund t'u ishin mohuar.

Këshillimi dhe orientimi për karrierë mund të zbatohet si pjesë e kurrikulës, përmes qendrave të karrierës, virtualisht apo individualisht. *(lexo më shumë në Shtojcat për nivelet përkatëse të APU-së.)*

Politikat në fushën e këshillimit dhe orientimit për karrierë, krahas parimit të gjithëpërfshirjes ndërsektoriale, duhet të bazohet në parimet e cilësisë, të bazuara në standardet e cilësisë. Qëllimi i përgjithshëm i këtyre standardeve unifikon organizimin dhe funksionimin e këshilltarëve për karrierë në gjimnaze për krijimin e një sistemi unik të cilësisë në fushën e këshillimit dhe orientimit për karrierë për zhvillimin e shkathtësive të menaxhimit të karrierës. *(lexo më shumë te Shtojcat përkatëse)*

Agjenda evropiane e shkathtësive 2020 konfirmon nevojën për të mbështetur të gjithë individët në rrugën e tyre të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe thekson rëndësinë e shërbimeve të karrierës, veçanërisht në mjediset shkollore. Në përputhje me këtë agjendë, qeveria e Kosovës në programin e saj 2021-2025 dhe MASHTI në Strategjinë e Arsimit 2022-2026 në kuadër të prioriteteve ka përfshirë edhe zhvillimin dhe fuqizimin e shërbimeve të këshillimit dhe orientimit për karrierë.

Në kontekstin e Kosovës këshillimi dhe orientimi për karrierë bëhet edhe më i rëndësishëm, duke pasur parasysh procesin e tranzicionit në të cilin është duke kaluar, si dhe kushtet jo të favorshme të tregut të punës. Nxënësit kanë nevojë për një mbështetje për karrierë kur marrin vendime për përzgjedhjen e shkollimit, gjatë kalimit të tyre nëpër nivele të ndryshme të arsimit, apo gjatë tranzicionit nga shkolla në botën e punës.

2. ORIENTIMI NË KARRIERË NË GJIMNAZE

Në Kosovë kemi politika arsimore, strategji dhe ligje të cilat i referohen nevojës për shërbime të këshillimit dhe orientimit në karrierë në nivelin e SHML:

- Kurrikula (Korniza Kurrikulare) e Arsimit Parauniversitar në Kosovë;
- Kurrikulat Bërthamë për gjimnaze;
- Ligji nr 04/L-032 – 2011 për Arsimin Parauniversitar;
- Ligji nr. 04/L-143 – 2013 për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve;
- Ligji për Arsimin e Lartë (nr. 04/L-037) i referohet promovimit të mësimin tërëjetësor, ndërmarrësisë dhe krijimit të lidhjeve mes institucioneve të arsimit të lartë dhe bizneseve;
- Udhëzuesi i Agjencisë së Akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë (MASHT, 2013), kërkon që institucionet të vlerësohen për shërbimet e ofruara për studentët, duke përfshirë edhe shërbimet për karrierë;

- Plani strategjik për arsim të Kosovës (PSAK) 2022-2026 një prej prioriteteve është edhe harmonizimi i sistemit arsimor me kërkesat e tregut të punës.

Kurrikula e gjimnazeve, në dy vitet e para te klasat 10-të dhe 11-të, fokusohet në zhvillimin themelor dhe të përgjithshëm, ndërsa te klasa e 12-të, ndihmon nxënësit që të konsolidojnë kompetencat e tyre mësimore. Gjatë kësaj periudhe nxënësit duhet përkrahur me mentorë/këshilltarë profesionalë, të cilët orientojnë ata në njohjen dhe zhvillimin e interesave të tyre personale për të nxënë dhe në përcaktimin e përshtatshëm të pritshmërisë së tyre në të ardhmen”. *(lexoni më shumë te shtojca I.)*

Shkallët kurrikulare te gjimnazet bazohen në një proces më të gjerë, më të thellë dhe më të specializuar të të nxënëit, duke pasur parasysh:

(a) orientimin e ardhshëm të nxënësve drejt studimeve akademike, drejt kualifikimeve profesionale (përfshirë arsimin postsekondar jouniversitar) dhe/apo inkuadrimin në tregun e punës, si dhe

(b) nevojën për t’i pajisur nxënësit me shkathtësi për të nxënë gjatë gjithë jetës. Në gjimnaze, procesi i përvetësimit të njohurive dhe zhvillimit të shkathtësive, rutinave, qëndrimeve, vlerave, dhe sjelljeve, bazohet në nevojën e të rinjve për të marrë përgjegjësinë për jetën e tyre, për të marrë pjesë si qytetarë aktivë dhe kompetentë në zhvillimet shoqërore dhe për t’u inkuadruar me sukses në tregun e punës. Te kjo fazë, nxënësit i nënshtrohen një procesi më sfidues të përvetësimit të dijeve, zhvillimit të potencialit të tyre intelektual, emocional dhe fizik.

Në Kosovë, së paku në pesë vitet e fundit ka pas përvoja të mira sa i përket aktiviteteve të karrierës. Në vitin 2018, MASHT ka lansuar platformën virtuale Busulla.com, e cila u ka shërbyer shkollave lidhur me të gjitha fushat e karrierës. Platforma është pasuruar me mbi një mijë profesione dhe informata tjera lidhur me tregun e shkollimit dhe të punësimit. Busulla.com, është pjesë e kurrikulës shkollore, te fusha ‘jeta dhe puna’, prandaj të gjithë mësimmdhënësit e kësaj fushe janë trajnuar për shfrytëzimin e saj dhe mbështetjen e nxënësve se si ta përdorin. Më tutje, përmes projekteve në bashkëpunim me donatorët, janë realizuar përvoja të mira të aktiviteteve me nxënëse sa i përket edukimit për karrierë: projekti i USAID ASSET/KEC ka trajnuar mësimmdhënësit e 16 gjimnazeve me programin Këshillim dhe orientim në karrierë, për të cilët edhe ka hartuar doracakun për mësimmdhënëse dhe në të njëjtat shkolla ka mbështetur themelimin e klubeve të karrierës nga nxënësit; projekti SolidarSuisse/KCDF ka qenë i fokusuar në periudhën tranzitore të nxënësve nga klasa e 9-të në të 10-tën, dhe nga klasa e 12-të në tregun e punës, i zbatuar në shkollat e katër komunave (Pejë, Klinë, Istog dhe Deçan), etj.

Është zhvilluar standardi i profesionit për këshilltarët e karrierës dhe validuar nga AKK. Sipas këtij standardi është zhvilluar programi kualifikues i nivelit të pestë, i cili është validuar nga AKK, si dhe programi ndërkombëtarë PEARSON, gjithashtu i nivelit të pestë.

Pozita e këshilltarit për karrierë është përfshirë në strukturën organizative të SHMU , të rregulluar me UA për menaxhimin e brendshëm të shkollave, si dhe është përfshirë në ligjin për pagat në sektorin publik.

3. STANDARDET MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLTARËVE PËR KARRIERË NË GJIMNAZE

Faktor i rëndësishëm për ofrimin cilësor dhe të qëndrueshëm të shërbimeve të orientimit në karrierë në SHML - gjimnaze është një strukturë e pajtuar e standardeve mbi organizimin dhe funksionimin e këshilltarëve për karrierë, me një mandat të qartë të tyre të rregulluar me legjislacion sekondar dhe udhëzime tjera relevante. Kjo do të siguronte burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare të mbështetura nga udhëheqja e shkollës dhe komuna, si dhe përgjegjësi të definuara të të gjitha palëve të interesit.

Në vazhdim janë paraqitur standardet dhe kërkesat minimale për organizimin dhe funksionimin e Këshilltarëve për Karrierë në SHML të ndara në pesë kapituj:

1. Misioni dhe objektivat
2. Roli i Këshilltarëve për Karrierë
3. Angazhimi dhe funksionimi i Këshilltarëve për Karrierë në IAP
4. Hapësirat dhe pajisjet e nevojshme për punën e Këshilltarëve për Karrierë
5. Monitorimi dhe vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë.

Standardi 1 - Misioni dhe objektivat

Emërtimi	Misioni dhe objektivat e Këshilltarëve për Karrierë
Qëllimi	Misioni dhe objektivat janë thelbësore për KK-të për të ofruar shërbime të fokusuara në nevojat dhe kërkesat e shkollës, nxënësve dhe për t'i shtuar vlerë zhvillimit të komunitetit lokal. Misioni dhe objektivat mund të ndryshojnë lehtësisht ndërmjet KK-ve, varësisht nga specifikat e mjedisit ku gjendet shkolla, mundësive të vazhimit të shkollimit në nivel më të lartë, kushteve teknologjike në dispozicion, etj. Por, është e rëndësishme dhe e përbashkët për të gjithë KK-të, t'i zhvillojnë shërbimet dhe t'i përcjellin reformat në sistemin arsimor në Kosovë.
Kërkesat	Më poshtë janë paraqitur misioni, objektivat strategjike dhe objektivat operacionale që çdo KK duhet t'i përmbushë.

MISIONI

KK-të në gjimnaze kanë për qëllim që të sigurojnë që çdo nxënës, te klasët 10-12, të arrijë potencialin e tij të plotë në jetë, duke u shkolluar në drejtim shkollor adekuat apo aftësuar në profesionin përkatës, i motivuar dhe të njoh ofertat për shkollim dhe punë

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OPERACIONALE

Te shkollat e mesme të larta (SHML) – gjimnazet, Këshilltarët e karrierës (KK) do të:

- Vlerësojnë përmes instrumenteve matëse të standardizuara.
- Identifikojnë çështjet që ndikojnë performancën akademike të nxënësve për orientim në karrierë.
- Mbështesin nxënësit të zhvillojnë: shkathtësi për të gjetur informacione për profesionet, për të praktikuar dhe të merr pjesë në aktivitete përmes aplikimeve; shkathtësi për vetëvlerësim, shkathtësi organizative, menaxhim të kohës, etj.
- Bashkërendojnë aktivitetet për informim të nxënësve, prindërve dhe personelit të shkollës për tema specifike; takime me prindër ose kujdestarë për të diskutuar pikat e forta dhe të dobëta të fëmijës së tyre.
- Monitorojnë gjithashtu zhvillimin akademik të nxënësve që kanë të bëjnë me këshillimin për karrierë.

OBJEKTIVAT OPERACIONALE

- Planet e punës së KK-ve që janë në shërbim në gjimnazit, duhet të ndërliken ngushtë me të priturat nga dokumentet kurrikulare, trendet e shkollimit, tregun lokal dhe global. Objektivat operacionale të punës së KK-ve duhet të ndërliken ngushtë me planet zhvillimore të shkollës –

	afatshkurta (njëvjeçare) dhe afatmesme (deri në 3 vite). Ato plane duhet të jenë specifike, dhe ndryshohen dhe adaptohen varësisht nga nevojat e shkollës/nxënësve.
--	---

Standardi 2 – Roli i Këshilltarëve për Karrierë

Emërtimi	Roli i Këshilltarëve për Karrierë
Qëllimi	KK-të në gjimnaze kanë për qëllim që të sigurojnë që çdo nxënës të arrijë potencialin e tij të plotë në jetë, duke u shkolluar në drejtim shkollor adekuat apo aftësuar në profesionin përkatës, i motivuar dhe të njoh ofertat për shkollim dhe punë
Kërkesat	<p>Paketa minimale e shërbimeve që KK-të duhet të ofrojnë, ndahet sipas grupeve të synuara:</p> <p>A. BASHKËPUNIMI ME NXËNËSIT</p> <p>A.1. Nxënësit e gjimnazeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • KK mbështetë vlerësimin e nxënësit përmes Busulla.com dhe interpreton rezultatet; vlerëson përmes pyetësorëve të standardizuar për këshillim dhe orientim në karrierë, përmes observimit dhe aktiviteteve jashtëkurrikulare, punës praktike, etj. • KK identifikon nxënësit me talente dhe ata me nevoja specifike, dhe plotëson të dhënat në databazë. • KK harton plane për orientim në karrierë dhe mbështetë nxënësit me nevoja të veçanta, lista të kontrollit në bazë të

informacionit që merr nga prindërit dhe mësimeve, mbështetë nxënësit në zhvillimin e shkathtësive të buta për jetë dhe punë.

- KK bashkërendon aktivitetet për të informuar nxënësit për mundësitë e studimeve akademike pas diplomimit, organizimin e vizitave informuese, diskutime dhe ligjërata nga profesionistë të fushave të ndryshme.
- Mbështetë nxënësit në themelimin e klubit të karrierës dhe këshillon mësimeve mentor të klubeve.
- KK monitoron zhvillimin akademik të nxënësve të caktuar apo grupeve të nxënësve, aktivitetet dhe zbatimin e planeve të punës që kanë të bëjnë me këshillimin për karrierë.

Informacionet dhe burimet për karrierën:

- KK-të duhet të përgatisin dhe përditësojnë rregullisht një sërë informacionesh dhe materialesh të vlefshme për të mbështetur nxënësit në marrjen e informacionit sa më të saktë dhe relevant për zgjedhjen e karrierës së tyre.
- KK-të duhet të udhëzojë dhe mbështetë mësimeve dhe nxënësit në përdorimin e platformës kombëtare Busulla.com - platformë unike për informim, edukim, këshillim dhe orientim për karrierë.

Shih [Shtojcën 2](#) për informacion shtesë.

Ngritja e shkathtësive të buta për karrierë dhe punësueshmëri:

- KK-të duhet të ofrojnë trajnime grupore për nxënësit/vijuesit, si dhe konsultime individuale sipas

nevojës, për ngritjen e shkathtësive të buta për zhvillim dhe menaxhim të karrierës dhe punësueshmërisë.

Shih Shtojcën 3 për informacion shtesë.

Organizimi dhe pjesëmarrja në ngjarje:

- KK-të në bashkëpunim me SHMU duhet të organizojnë pjesëmarrjen e nxënësve të kl 9-ta të paktën në një panair të edukimit dhe karrierës për vit shkollor dhe në aktivitetet e dyerve të hapura.
- KK-të janë përgjegjës të zhvillojnë kalendarin e aktiviteteve për vajza (p.sh. dita e vajzave, vajzat në TIK, mysafir folës nga gra të suksesshme në karrierë, etj.) dhe grupet minoritare (p.sh. dita e ndërmarrësisë për të fuqizuar vullnetin e tyre për shkollim dhe punësueshmëri) dhe t'i realizojë ato në bashkëpunim edhe me akterë tjerë relevant (p.sh. zyra komunale për minoritete, organizata rinore, etj.).
- Duhet të zbatohen aktivitete për nxënësit /vijuesit me nevoja të veçanta.
- Të dizajnohet metodologjia për matjen e kënaqshmërisë së klientëve.
- Mirëmbajtja dhe përdorimi i Sistemeve Digjitale, duke ndjekur udhëzimet administrative dhe rregulloret tjera përkatëse të parashikuara nga MASHTI, Komuna dhe SHML-të. Ky sistem është minimumi që KK-të duhet të përdorin:
 - Sistemi për gjurmimin e nxënësve pas diplomimit.

A.2. Nxënësit e ardhshëm (nga SHMU-të)

- KK-të në gjimnaze duhet të organizojnë ngjarjen e Ditëve të Hapura për çdo vit shkollor për nxënësit e klasës së 9-të për t'i ndihmuar ata për një zgjedhje të informuar për karrierë. Ngjarja duhet të zgjasë disa ditë dhe mund të ndodhë më së largu në fillim të gjysmëvjetorit të dytë të klasës 9-të.
- KK bashkëpunon me ekipin për braktisjen e shkollës, për informim dhe mbështetje të tyre në karrierë.

B. BASHKËPUNIMI ME KOMUNITETIN

- KK-të duhet të krijojnë partneritete me prindërit, palë të ndryshme me interes, duke nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit apo marrëveshje të vullnetit të mirë.
- KK-të duhet të bashkëpunojnë së paku me partnerët e mëposhtëm:
 - Komuna:
Ato mund të ftohen të marrin pjesë në ngjarje të karrierës; ato mund të ndihmohen në organizimin e ngjarjeve të komunitetit lokal duke i promovuar ato në mesin e nxënësve apo duke ofruar vullnetarë, etj.
 - Organizatat e biznesit në nivel lokal dhe qendror:
Ato mund të ftohen të marrin pjesë në ngjarje të karrierës dhe sesione të ndryshme për të ofruar informacione për tregun e punës.
 - OJQ-të, organizatat rinore: Ato promovojnë iniciativa përkatëse që mund të jenë të dobishme për nxënësit.
 - Prindërit dhe Këshilli i Prindërve: Mund të ftohen në ngjarje të karrierës dhe aktivitete tjera të shkollës.

	<ul style="list-style-type: none"> ○ Organizatat donatore: KK-të mund të marrin pjesë në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve ose iniciativave të financuara nga donatorët që i shtojnë vlerë shërbimeve të karrierës. ● KK-të duhet të jenë pjesëmarrës në aktivitete të lidhura me zhvillim të politikave në fushën e karrierës, si grupe pune, konferenca, etj. ● Rrjetëzimi i KK-ve është i rëndësishëm për shkak të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira dhe bashkëpunimit për të zhvilluar shërbime, materiale dhe informacione të karrierës.
--	---

Standardi 3 – Angazhimi dhe funksionimi i Këshilltarëve për Karrierë në gjimnaze

Emërtimi	Angazhimi dhe funksionimi i Këshilltarëve për Karrierë në IAAP
Qëllimi	Përcaktimi i numrit dhe funksionit të KK-ve të angazhuar varësisht nga numri i nxënësve në gjimnaz.
Kërkesat	<p>Numri i Këshilltarëve për Karrierë</p> <p>Të gjitha gjimnazet duhet të përfitojnë shërbime nga KK-të. Numri i KK-ve përcaktohet varësisht nga numri i nxënësve, siç është specifikuar në kategoritë e mëposhtme.</p> <p>1. Në gjimnaz me deri në 500 nxënës:</p>

- 1.1. Një KK me normë të plotë për bashkëpunim me nxënës, mësimdhënës dhe komunitetin, për tërë shërbimet/aktivitetet që ofrohen.
- 1.3. KK mund të angazhohet për më shumë se një gjimnaz në të njëjtën komunë, por jo të shërbejë më shumë se 500 nxënës gjithsej.
- 1.4. Nëse pozita e KK-së nuk mbulohet me normë të plotë, atëherë me propozim të gjimnazit, DKA plotëson këtë normë të plotë me dy gjysmë norma.
- 1.5. Norma e plotë për KK është e njëjtë si e punëtorëve profesional

2. Në gjimnaze me 501 deri në 1000 nxënës:

- 2.1. Dy KK me norma të plota për bashkëpunim me nxënës, mësimdhënës dhe komunitetin.
- 2.2. KK-të mund të angazhohen për më shumë se një gjimnaz në të njëjtën komunë, por jo të shërbejë më shumë se 1000 nxënës gjithsej.
- 2.4. Nëse dy pozitat e KK-ve nuk mbulohen me norma të plota, atëherë me propozim të SHMU-së, DKA plotëson këto dy norma të plota me gjysmë norma.
- 2.5. Norma e plotë për KK-ve është e njëjtë si e punëtorëve profesional.

3. Në SHMU me mbi 1000 nxënës.

- 3.1. Dy KK me norma të plota për bashkëpunim me nxënës, mësimdhënës dhe komunitetin.
- 3.2. KK-të i shërbejnë vetëm një gjimnazi.

3.4. Nëse dy pozitat e KK-ve nuk mbulohen me norma të plota, atëherë me propozim të shkollës, DKA plotëson këto dy norma të plota me gjysmë norma.

3.5. Norma e plotë për KK-ve është e njëjtë si e punëtorëve profesional.

Funksioni /Pozita e Këshilltarëve për Karrierë:

KK-të mund të jenë personel mësimdhënës që funksionojnë në kuadër të gjimnazit, nëse e plotësojnë kushtin që të kenë diplomën e kualifikimit për këshilltarë karriere.

Në rast të mungesës së mësimdhënësve brenda atij gjimnazi, DKA me vendim të posaçëm emëron mësimdhënës nga institucionet tjera arsimore të komunës së njëjtë.

KK-të janë pjesë e skemës organizative të SHML në kuadër të Këshillit Profesional, sipas UA për menaxhimin e brendshëm të shkollave.

KK-të me propozim të SHML-së përzgjidhen nga DKA sipas përshkrimit të detyrave dhe kompetencave të përcaktuara.

KK-të pajisen me kontratë nga DKA-të, me kohë të pacaktuar me orar të plotë si punëtorët profesional, ose si mësimdhënës (te rastet kur KK-të janë me gjysmë norme).

Kualifikimi dhe shkathtësitë e Këshilltarëve për Karrierë

Sipas standardeve ndërkombëtare, rekomandohet që KK të posedojë kualifikimin 6 apo 7 të KKK (ekuivalent me Baçelor apo Master). Në Kosovë, derisa nuk kemi shkollim akademik të këtyre niveleve, për gjimnaze KK-të duhet të certifikohet me programin kualifikues të nivelit të 5-të, sipas PEARSON.

	<p><i>Shih <u>Shtojcën 4</u> për informacion shtesë.</i></p> <p>Raportimi i Këshilltarëve për Karrierë</p> <p>KK-të raportojnë sipas hierarkisë në skemën organizative të SHML-së.</p> <p>Për punën e KK-ve, drejtori i SHML-së /gjimnazit raporton në DKA, siç raporton edhe për punën e mësimdhënësve të tjerë.</p>
--	--

Standardi 4 - Hapësirat dhe pajisjet e nevojshme për punën e Këshilltarëve për Karrierë

Emërtimi	Hapësirat dhe pajisjet e nevojshme për punën e Këshilltarëve për Karrierë
Qëllimi	Përcaktimi i hapësirave dhe pajisjeve të punës të nevojshme për ofrimin cilësor të shërbimeve të karrierës.
Kërkesat	<p>Hapësirat e punës për Këshilltarët për Karrierë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hapësirat e punës duhet të jenë brenda SHML-së/gjimnazit për të formuar një mjedis të këndshëm që stimulon funksionimin efektiv të punës së KK-ve. • Duhet të kenë sinjalistikë shumë të dukshme në mënyrë që të identifikohen lehtësisht nga vizitorët. <p>Hapësirat dhe sipërfaqet e obligueshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Një zyrë me sipërfaqe 15-25m²; • Shkolla duhet të sigurojë një hapësirë/klasë për organizimin e aktiviteteve të KK, me ndriçim natyral dhe mundësi për ajrosje

natyrale, me perde për mbrojtje nga dielli (nëse ka nevojë) dhe kondicioner për ftohje/ngrohje;

- Qasja në këto dy hapësira duhet të jetë e përshtatshme për persona me vështirësi në lëvizje, gjithashtu nga ana e jashtme të jetë në dispozicion pjerrina e përshtatshme për persona që lëvizin me karroca;
- Qasja e lehtë në nyjën sanitare.

Mobileria e nevojshme për hapësirat e punës dhe ofrimin cilësor të shërbimeve:

- Zyra duhet të ketë se paku një tavolinë pune dhe karrige, dhe dy ulëse për vizitorë, dollap për materiale promovuese të karrierës;
- Salla mund të ketë një tavolinë të madhe rrethore ose disa tavolina më të vogla të cilat mund të ofrojnë fleksibilitet në organizim, 26 karrige, një TV ekran me mundësi të lidhjes me kompjuter, rafte dhe dollapë në muret anësore të pajisur me shumë materiale për edukim në karrierë;
- Disa varëse për pallto për pjesëmarrësit.

Pajisjet teknologjike:

- Laptop për secilin KK;
- 1 printer multifunksional (printer, fotokopje, skaner);
- 1 PC që mund të përdoret për të instaluar sistemet digjitale të punës dhe për t'u përdorur si databazë;
- disa PC për përdorim të grupeve të cilët kanë nevojë për këshillime individuale;
- 1 TV ekran i rrafshët.

Lidhja me rrjetin dhe internetin:

Internet cilësor me kabëll apo wireless.

Standardi 5 - Monitorimi dhe vlerësimi i Këshilltarëve për Karrierë

Emërtimi	Monitorimi dhe vlerësimi i Këshilltarëve për Karrierë
<p>Qëllimi</p>	<p>Përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për monitorim dhe vlerësim të këshilltarëve për karrierë në përmbushjen e objektivave dhe rezultateve.</p>
<p>Kërkesat</p>	<p>Vlerësimi i objektivave strategjike</p> <p>Behet çdo 3 vjet, nga drejtori i SHML-së/Gjimnazit në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin mësimor, Këshillin profesional në shkollë, në bashkëpunim me KK-të, i cili raporton në DKA dhe sipas kërkesës edhe në MASHTI.</p> <p>Vlerësimi i objektivave operacionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> • KK-të hartojnë planin vjetor të punës për SHMU-të përkatëse më së voni në gusht për vitin e ri shkollor. Plani aprovohet nga këshilli mësimor dhe drejtori i shkollës; • Raportin e progresit të planit vjetor të punës e harton KK; • Vlerësimi i raportit të progresit bëhet nga drejtori i SHMU-së. <p>Vlerësimi i progresit të Planit Vjetor të Punës bëhet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në vitin e parë të angazhimit të KK-ve, dy herë në vit, pas gjysmëvjetorit të parë dhe pas gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor; • Pas vitit të parë, një herë në vit pas përfundimit të vitit shkollor. <p>Vlerësimi i rezultateve:</p>

KK-të planifikojnë rezultatet e pritshme bazuar në Planin Vjetor të Punës. Monitorimi i rezultateve bëhet vazhdimisht nga KK-të sipas treguesve të mëposhtëm:

- Numri i punëtorive/sesioneve informuese/trajnimeve të organizuara sipas temave;
- Numri i nxënësve të përfshirë në punëtori/sesione informuese/trajnime sipas klasave dhe të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike;
- Numri i nxënësve të mbështetur për punësim sipas klasave dhe të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike;
- Numri i nxënësve të përgatitur me shkathtësitë e buta për realizim të suksesshëm të punës vullnetare apo praktikave në biznese;
- Numri i ngjarjeve të organizuara;
- Numri i nxënësve që ndoqën ngjarjet sipas klasave dhe të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike;
- Numri i bizneseve unike² që bashkëpunojnë me KK-të.

Raportin mbi rezultatet e arritura e harton KK dhe e vlerëson drejtori i SHMU-së si në vijim:

- Në vitin e parë të angazhimit të KK-ve, dy herë në vit, pas semestrit të parë dhe pas semestrit të dytë të vitit shkollor.
- Pas vitit të parë të angazhimit të KK-ve, një herë në vit pas përfundimit të vitit shkollor.

Sigurimi i cilësisë

KK-të përdorin sistemin e brendshëm të monitorimit të kënaqshmërisë së klientëve me shërbimet e ofruara dhe aktivitetet e realizuara, për:

² Numri i bizneseve unike nënkupton bizneset që regjistrohen në databazë njëherë, dhe jo sa herë të angazhohen në aktivitete të ndryshme

- Nxënësit e SHML-së/gjimnazit
- Nxënësit e ardhshëm (nga SHMU)
- Bizneset
- Prindërit /Anëtarët e komunitetit.

KK-të përdorin sistemin e gjurmimit të të diplomuarve për çdo të diplomuar, bazuar në SMIAL.

PËR GJIMNAZE

Shtojca 1. Edukimi për karrierë

Edukimi për karrierë mund të zbatohet sipas modeleve të ndryshme:

- **Si pjesë e kurrikulës** (përmes një fushe/lënde mësimore apo përmes të gjitha lëndëve, si çështje ndërkurrikulare, përmes aktiviteteve të klubeve të karrierës, etj.);
- **Përmes Qendrave/Zyrave të Karrierës** (mund të jenë me bazë në shkollë, apo në nivel lokal/qendror);
- **Modeli individual** (sipas interesave dhe mundësive të individit);
- **Modeli virtual** (platformat simuluese për informim, këshillim dhe orientim – busulla.com).

Në sistemin e arsimit parauniversitar në Kosovë, edukimi për karrierë adresohet përmes hierarkisë së dokumenteve kurrikulare: politikave arsimore (Korniza e kurrikulit – Kurrikula e Kosovës) dhe dokumenteve operacionale të arsimit (Kurrikulat bërthamë për nivele arsimore, Shkallëve kurrikulare, dhe kurrikulat e fushave/lëndëve mësimore). Kjo hierarki e dokumenteve kurrikulare krijon sistemin e rezultateve të të nxënit, të cilat ndihmojnë të përcaktohet edhe kualifikimi për ofruesit e shërbimeve të edukimit në karrierë.

<u>Hierarkia e dokumenteve të kurrikulumit</u>	<u>Sistemi i rezultateve të të nxënit</u>
KORNIZA E KURRIKULIT TË KOSOVËS	<u>Rezultatet kryesore të të nxënit që shprehin nivelin e domosdoshëm të arritshmërisë së gjashtë kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të arsimit parauniversitar</u>
KURRIKULI BËRTHAMË PËR SHKALLËT E KURRIKULUMIT 1 - 6	<u>Rezultatet esenciale të të nxënit që shprehin nivelin e domosdoshëm të arritshmërisë së gjashtë kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të çdo shkalle të kurrikulit</u>
	<u>Rezultatet e të nxënit për secilën fushë të kurrikulit gjatë një shkalle të kurrikulare</u>
PLAN-PROGRAMET LËNDORE	<u>Rezultatet e të nxënit sipas lëndëve, për secilën klasë</u>

Për realizimin e edukimit në karrierë si pjesë e kurrikulës, janë përgjegjës mësimmshënësit e të gjitha fushave mësimore, por në veçanti të fushës ‘jeta dhe puna’. Kjo bëhet përmes një orari të strukturuar mirë gjatë një viti shkollor, ku realizohen rezultatet e pritura nga secila fushë/lëndë, monitorohen dhe vlerësohen. Ndërsa, me futjen e pozitës së Këshilltarit të karrierës nëpër institucionet shkollore, përcaktohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj gjatë një viti apo disa viteve shkollore. Detyra e KK-ve është që të mbështesin menaxhmentin shkollor, mësimmshënësit, nxënësit dhe prindërit. Kjo duhet të bëhet në bazë të një plani të strukturuar dhe të monitoruar rregullisht.

Në secilin nivel shkollor, KK-të do të përkujdesen që nxënësit të ekspozohen në tri fushat e edukimit për karrierë:

- I/ Zbulimi dhe të kuptuarit e vetvetes
- II/ Perceptimi i mundësive në botën e edukimit dhe punës
- III/ Krijimi dhe menaxhimi i karrierës.

Te SHML: Pritet që nxënësit të kalojnë nga shkalla e tretë dhe katërt kurrikulare (zhvillim i mëtejshëm, përforsim dhe orientim), nëpër shkallët kurrikulare të pestë dhe gjashtë të cilat do të fokusohen në:

- Zhvillim themelor të përgjithshëm, dhe
- Konsolidim.

Në përputhje me këto përgjegjësi, dokumentet kurrikulare përcaktojnë sistemin e rezultateve të pritura që të realizohen nga mësimdhënësit, më specifiku te fusha kurrikulare 'jeta dhe puna'. Këto koncepte patjetër se duhet të ndërlihen në formë të kontinuitetit nga SHMU, duke filluar nga shkalla kurrikulare 3 dhe 4, kur mësimdhënësit klasor ofrojnë konceptet e karrierës përmes fushës mësimore 'jeta dhe puna'. Në nivelin e SHML, nëpër shkallët kurrikulare 5 dhe 6, përgjegjësinë më të madhe për konceptet e karrierës e kanë mësimdhënësit e fushës mësimore 'jeta dhe puna', e cila përveç koncepteve të edukimit për karrierë e përfshinë edhe TIK-un, edukimin për ndërmarrësi dhe edukimin e qëndrueshëm.

KK-të duhet të mbështesin personelin mësimor në realizimin e koncepteve të karrierës. Përtej kësaj, ata do të planifikojnë dhe realizojnë aktivitete shtesë me të gjithë nxënësit e klasave 10-12, me tema të ndryshme që i përkasin karrierës (organizojnë teste të ndryshme grupore, ofrojnë burime të ndryshme-online apo kopje fizike të informacioneve për profesionet, dhe këshillojnë lidhur me kërkesat e tregut të punës).

Lexo më shumë te Shtojca 4.

Shtojca 2. Informacionet dhe burimet për karrierën

Te SHML/Gjimnazet, Këshilltarët për Karrierë dhe mësimdhënësit e fushës 'jeta dhe puna' shfrytëzojnë platformën nacionale Busulla.com që të vlerësojnë dhe informojnë nxënësit për mundësitë e shkollimit të mëtejshëm universitar dhe punësimit në treg të punës. Organizojnë vizita për nxënësit e SHMU-ve, klasave të 9-ta. Këshilltarët për Karrierë gjithashtu informojnë nxënësit për mundësitë për punësim brenda dhe jashtë vendit, mundësitë e trajnimit dhe mobilitetit, bursat dhe programet universitare, shërbimet vullnetare, ngjarje dhe informacione të tjera që lidhen me zhvillimin e karrierës.

Këshilltarët për Karrierë planifikojnë aktivitetet vjetore lidhur me ofrimin e informacioneve për karrierën, duke përfshirë punëtoritë, sesionet informuese, panairët e karrierës, prezantimet e punëdhënësve ose ngjarje të tjera. Në këto aktivitete përfshihen nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit. Ata ofrojnë materiale informuese të printuara apo elektronike sipas nevojës.

Shtojca 3. Ngritja e shkathtësive të buta për karrierë dhe punësueshmëri

Realizimi i kurrikulit shkollor kërkon një qasje gjithëpërfshirëse për të arritur qëllimin e plotë. Nëse analizojmë rezultate t e pritura kurrikulare nëpër nivele të ndryshme shkollore, mund të gjejmë se ato kryesisht adresojnë një pjesë të elementeve të kompetencave mësimore: njohuritë/dijet, shkathtësitë dhe rutinat e nxënësve. Por, edhe tri elemente tjera të rëndësishme të kompetencës mësimore mbetet të adresohen disi, e ato janë qëndrimet, vlerat dhe sjelljet e nxënësve. Përmes adresimit të këtyre elementeve të kompetencave mësimore, ne mund të zhvillojmë pakon e nevojshme të shkathtësive të buta, të cilat krijojnë sistemin e vlerave të nevojshme për jetë, punësim apo vetëpunësim të nxënësve. Lista e shkathtësive të buta mund të jetë më e gjatë po më shkurtër dhe secili vend apo organizatë mund të krijojë një set të domosdoshëm/relevant të atyre shkathtësive. Është e njohur se shkathtësitë e buta mund të ndihmojnë menaxhimin e karrierës duke sjellë një sërë kompetencash që u mundësojnë individëve dhe grupeve të kenë një mënyrë të strukturuar për mbledhjen, analizimin, unifikimin dhe organizimin e të dhënave personale, arsimimin dhe punësimin, si dhe shkathtësitë e tranzicionet drejt vendimarrjes.

Disa nga shkathtësitë e buta që ndikojnë shumë në edukim të karrierës janë:

- **Të menduarit kritik dhe kreativ:**

Mendimi kritik përshkruhet si një shkathtësi për të pyetur, për të provuar supozimet e ngritura, për të njohur paqartësitë, për të interpretuar, vlerësuar e gjykuar. Mendimi kritik është proces i të menduarit reflektues dhe të arsyeshëm. Kreativiteti është aftësia për të parë gjërat ndryshe dhe për të gjetur mënyra të reja për zgjidhjen e problemeve. Ai mund të shihet si një proces dhe/ose një produkt dhe përgjithësisht mendohet si prodhim i zgjidhjeve të dobishme për problemet.

- **Komunikimi efektiv:**

Shkathtësitë e komunikimit janë kritike dhe parashikuese të suksesit në karrierë dhe mirëqenies individuale. Komunikuesit efektiv i shprehin idetë e tyre me gojë apo me shkrim në mënyrë efikase dhe gjenerojnë e përpunojnë mesazhe në atë mënyrë që u mundëson atyre të realizojnë qëllimet e caktuara. Ata e vënë theksin në aftësitë ndërpersonale, përgjegjësinë personale, përgjegjësinë sociale dhe qytetare.

- **Zgjidhja e problemeve:**

Shkathtësia për zgjidhjen e problemeve e një individi paraqet gatishmërinë për t'u përfshirë në situata problemore për të arritur potencialin e një personi si qytetar konstruktiv dhe reflektues. Kjo shkathtësi zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme duke e vendosur veten në situata të reja që kërkojnë zgjidhje dhe që mund të transferohen në kontekste të ndryshme.

- **Inteligjenca emocionale:**

Inteligjenca emocionale është kapaciteti për të arsyetuar emocionet dhe për të forcuar të menduarit. Ajo përfshin aftësitë për të perceptuar me saktësi emocionet, për të rifituar dhe gjeneruar emocione, për të ndihmuar të menduarit, të kuptuarit e njohurive për emocionet, dhe për të rregulluarit në mënyrë reflektuese të emocioneve që promovojnë rritjen emocionale dhe intelektuale

- **Këmbëngulësia:**

Këmbëngulja është vazhdimësia e përpjekjes dhe realizimit në mënyrë të plotë dhe të kujdesshme të një qëllimi të caktuar, ndërsa tejkaloni vështirësitë, pengesat ose dekurajimin e paparashikuar gjatë rrugës, duke ndryshuar planin tuaj të ndërhyrjes. Këmbëngulja mund të shihet edhe si një model vendimesh relativisht të qëndrueshme dhe angazhim për punë të madhe drejt arritjes së një qëllimi.

- **Puna ekipore:**

Puna ekipore mund të përkufizohet si punë e kryer nga një grup njerëzish të bashkuar për të realizuar një detyrë të veçantë me efikasitet më të madh sesa kur detyra kryhet pa bashkëpunim. Secili anëtar i ekipit bën një pjesë të detyrës dhe i nënshtrohet kërkesave të situatës në mënyrë që të nxjerrë përfitime personale për veten e tij duke bashkëpunuar me të tjerët. Një anëtar i ekipit duhet të bashkëveprojë me të tjerët, të arrijë pajtueshmëri, të jetë mbështetës, i dobishëm dhe bashkëpunues.

- **Ndërgjegjshmëria:**

Ndërgjegjësimi është një spektër i konstruksioneve që përshkruajnë dallimet individuale në tendencën për të qenë të vetëkontr olluar, përgjegjës ndaj të tjerëve, punëtorë, të rregullt dhe që i respektojnë rregullat. Ndërgjegjësimi parashikon arritjen më të lartë në shkollën e mesme dhe në studime dhe është e pavarur nga aftësia kognitive.

- **Mbledhja e informatave:**

Shkathtësitë për mbledhjen e informatave i referohen shkathtësisë për të identifikuar burimet e të dhënave, mbledhjen dhe analizën e tyre me qëllim të zgjidhjes së problemeve të ndryshme. Këto shkathtësi e bëjnë një individ të jetë i aftë që të përdorë teknologjinë si mjet për të hulumtuar dhe menaxhuar informacionet në mënyrë efikase. Është e rëndësishme që individi të jetë i aftë të vlerës ojë cilësinë dhe rëndësinë e burimeve të informacionit dhe të jetë i vetëdijshëm për besueshmërinë e tyre.

Shkathtësitë e buta mund të zhvillohen edhe gjatë procesit të rregullt mësimor prandaj, për të mos u përsëritur, KK-të dhe mësimdhënësit pajtohen për ndarjen e aktiviteteve në mes vete. KK-të duhet të ofrojnë trajnime grupore për nxënësit, si dhe konsultime individuale sipas nevojës, për ngritjen e shkathtësive për zhvillim dhe menaxhim të karrierës dhe punësueshmërisë.

Ky program trajnimi komplimenton temat e zhvilluara në kuadër të Edukimit për Karrierë.

Të gjithë nxënësit duhet gradualisht gjatë shkollimit të ekspozohen në zhvillimin e shkathtësive të buta, edhe pse mund t'u jepet prioritet klasave tranzitore, klasës 9-të dhe 12-të për t'i përgatitur ata për nivel tjetër arsimor apo qasje në tregun e punës dhe punësueshmëri.

Temat e trajnimit :

- Përgatitja e CV-së dhe letrës motivuese.
- Përgatitja për intervistë të punës.
- Hulumtimi për vende të punës dhe rishikimi i një oferte për punësim.
- Hulumtimi i shkollave të mesme të larta dhe programeve të tyre.
- Hulumtimi i programeve universitare dhe programeve trajnuese për arsim dhe aftësim të mëtutjeshëm dhe përgatitja për aplikim.
- Projekte jashtëmësimore për të zhvilluar shkathtësitë e buta tek nxënësit.

Aktivitete tjera të lidhura me karrierën përfshirë mobilitetin e nxënësve, punën vullnetare dhe trajnime ekstra kurrikulare.

Shtojca 4: Përshkrimi i detyrave të Këshilltarëve për Karrierë- Informatë fillestare lidhur me resurset njerëzore

Personeli që punojnë në fushën e karrierës duhet të posedojnë pako të caktuar të kompetencave. Organizatat ndërkombëtare të cilat merren profesionalisht me karrierën, ndajnë tri lloje të kualifikimeve të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK), e cila është kompatible me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) në Kosovë. Këto tri kualifikime janë: Këshilltarë karriere, Praktikues karriere, Specialist karriere.

Këshilltarët e karrierës mund të jenë mësimdhënës, menaxherë të punësimit, psikolog, punëtorë social, etj. Këta nuk janë profesionist të karrierës, por profesionist të një fushe tjetër, të cilët ofrojnë një lloj të mbështetjes në karrierë, si plotësim i punës dhe funksionit të tyre primar. Por, janë në gjendje të ofrojnë mbështetje dhe këshilla bazë në nivel të besueshëm të cilësisë, dhe të kuptojnë nëse individit do të përfitojë nga shërbimi i tyre profesional. Ky kualifikim i takon nivelit 6 të KKK.

Praktikuesit e karrierës janë profesionist (këshilltarë karriere, këshilltarë të punësimit, mentorë të karrierës, këshilltarë shkollor, zhvillues të personelit, këshilltarë të edukimit ose udhëheqjes, etj.). Këta janë të përqendruar në fushën e edukimit për karrierë dhe këtë e shohin si profesion të tyre primar, për të mbështetur njerëzit gjatë sfidave komplekse të karrierës së tyre. Janë të gatshëm të mbështesin individët të cilët ballafaqohen me pasiguri, probleme shumëplanëshe dhe situata të paparashikueshme. Ky kualifikim është kompetent të mbështetë zhvillime të qasjeve strategjike, të ofrojë qasje në njohuri shumë të specializuara, dhe ndihmon klientët në ballafaqim me faza stresuese gjatë tranzicionit si dhe projekte të ndryshimeve personale. Ky kualifikim i takon nivelit 7 të KKK.

Specialistët e karrierës janë profesionist, të cilët marrin përgjegjësi më të gjerë për profesionin e karrierës dhe punojnë drejt avancimit në mënyra të ndryshme. Disa prej tyre fokusohen në çështje praktike (psh. menaxhimin e shërbimeve të karrierës, politikbërjes ose të mbikëqyrjes së profesionistëve tjerë të karrierës, të dy niveleve të mëparshme). Të tjerët, mund të angazhohen në hulumtime dhe zhvillime ose trajnime akademike në fushën e edukimit për karrierë. Specialistët janë në gjendje të performojnë si praktikues karriere, të demonstrojnë autoritet substancial, integritet studiues dhe profesional të fokusuar në edukimin për karrierë. Ky kualifikim i takon nivelit 8 të KKK.

Pearson është program i nivelit të 5 të kualifikimeve.

Kushtet e përgjithshme

- KK-të raportojnë sipas hierarkisë në skemën organizative të institucionit ku veprojnë.
- Te SHMU, KK-të mund të jenë mësimdhënës të cilët kanë të përfunduar programin kualifikues PIRSON.
- Norma e punës për pozitën e KK-ve është e njëjtë si e punëtorëve profesional në SHMU.

Detyrat kryesore

Shërbimet për nxënësit dhe mësimdhënësit e SHMU-së

- Sipas standardit 1, objektivat strategjike dhe operacionale.
- Sipas standardit 2, pika A.1

Shërbimet për nxënësit e ardhshëm

- Sipas standardit 2, pika A.2.

Shërbimet për komunitetin

- Sipas standardit 2, pika B.

Punët administrative

- Zhvillimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për nxënës, akterë nga komuniteti dhe palë tjera të interesit.

- Mirëmbajtja dhe përditësimi i kanaleve mediale sociale lidhur me aktivitetet e zhvilluara
- Mbajtja e evidencës mbi aktivitetet e zhvilluara dhe mbështetja gjatë hartimit të raporteve të progresit.
- Mbikëqyrja e nxënësve vullnetarë që ndihmojnë KK-të.
- Mbajtja e shënimeve të sakta për aktivitetet dhe rezultatet (monitorimi dhe vlerësimi).

Marketingu dhe Promocioni

- Promovimi i shërbimeve të karrierës për grupe të ndryshme të synuara nëpërmjet ngjarjeve të ndryshme, publikimeve, aktiviteteve online, etj..
- Promovimi i shërbimeve të karrierës përmes mediave sociale dhe mediave nacionale.
- Zhvillimi i publikimeve dhe materialeve promovuese.

Njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme

- Njohuri dhe shkathtësi për vendimmarrje
- Njohuri dhe shkathtësi për planifikim
- Shkathtësi komunikuese dhe prezentuese
- Shkathtësi për menaxhimin e kohës
- Shkathtësi për punë në ekip
- Njohuri dhe shkathtësi për zhvillim dhe mbajtje të trajnimeve
- Njohuri për rrjetëzim
- Shkathtësi për zgjidhje të problemeve dhe negocim
- Njohuri dhe shkathtësi digjitale
- Shkathtësi ndërmarrëse
- Njohje e gjuhëve të huaja (e dëshirueshme).



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit- Ministarstva za Obrazovanje
Nauku, Tehnologiju i Inovacija-Ministry of Education Science, Technology and Innovation*

Standardet për organizimin dhe funksionimin e Këshilltarëve për Karrierë në institucionet e Shkollave të Mesme të Ulëta (SHMU)

Qershor, 2023

Përmbajta

1. HYRJE.....	3
2. ORIENTIMI NË KARRIERË NË SHMU NË KOSOVË	4
3. STANDARDET MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLTARËVE PËR KARRIERË NË SHMU	6
Standardi 1 - Misioni dhe objektivat	6
Standardi 2 – Roli i Këshilltarëve për Karrierë	9
Standardi 3 – Angazhimi dhe funksionimi i Këshilltarëve për Karrierë në SHMU	13
Standardi 4 - Hapësirat dhe pajisjet e nevojshme për punën e Këshilltarëve për Karrierë	15
Standardi 5 - Monitorimi dhe vlerësimi i Këshilltarëve për Karrierë.....	18
4. SHTOJCAT	1
Shtojca 1. Edukimi për karrierë	1
Shtojca 2. Informacionet dhe burimet për karrierën	3
Shtojca 3. Ngritja e shkathtësive të buta për karrierë dhe punësueshmëri	3
Shtojca 4: Përshkrimi i detyrave të Këshilltarëve për Karrierë- informatë fillestare lidhur me resurset njerëzore	6

Shkurtesat

AAAPARr	Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
CEDEFOP	Qendra Evropiane për Zhvillimin e Formimit Profesional
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
EYE	Rritja e Punësimit për të Rinj
IAEVG	International Association for Education and Vocational Guidance
IAP	Institucionet e Arsimit Parauniversitar
IAAP	Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MVP	Mësimi në Vendin e Punës
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës
QAP	Qendra e Aftësimit Profesional
QeK	Qendra e Kompetencës
KK	Këshilltarët për Karrierë
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve

KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
SHML	Shkollat e Mesme të Larta
SHMU	Shkollat e Mesme të Ulëta

3. HYRJE

Këshillimi dhe orientimi për karrierë, si koncept më i gjerë i cili përfshin: informimin, edukimin, këshillimin, orientimin dhe menaxhimin e karrierës gjatë gjithë jetës, është bërë më i rëndësishëm se asnjëherë më parë. Aktualisht në vendin tonë, por edhe globalisht, po ndodhin shumë ndryshime: transformime digjitale, zhvillim i ekonomisë së gjelbër, përshtetshmëri ndryshimeve demografike, etj. Si rrjedhojë, individët po navigojnë në një treg pune gjithnjë e më kompleks. Në të njëjtën kohë, realitetet sfidues mbetet papunësia e lartë e të rinjve dhe prezenca e sektorëve të mëdhenj informal. Prandaj, orientimi për karrierë, është kyç për të ndihmuar individët që të përmirësojnë shkathhtësitë, të rikualifikohen, të zhvendosin vendet e punës dhe të menaxhojnë jetën dhe punën e tyre. Mbështetja për zhvillimin e karrierës është gjithashtu kyç në arritjen e objektivave strategjike në politikat e arsimit, trajnimit dhe punësimit, si dhe në mbështetjen e zhvillimit të shkathhtësive sektoriale.

Këshillimi dhe orientimi për karrierë është proces kompleks dhe i vazhdueshëm, i cili zgjat nga ‘*djepi deri në pleqëri*’. Në shekullin tonë, trendet globale po sugjerojnë të kemi ‘zhvillim gjatë tërë jetës si standard’³.

Qëllimet e këshillimit dhe orientimit për karrierë ndahen në tri kategori kryesore:

- *Qëllimet e të nxënit*, duke përfshirë përmirësimin e efikasitetit të sistemit arsimor gjithpërfshirës dhe ndërlidhjes së tij me tregun e punës. Nëse individët marrin vendime në bazë të informatave të mira, lidhur me interesat, kapacitetet dhe aspiratat e tyre, investimet në sistemet e arsimit kthehen me përfitime të larta.
- *Qëllimet e tregut të punës*, duke përfshirë përmirësimin e përputhjes ndërmjet ofertës dhe kërkesës dhe menaxhimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve. Nëse njerëzit gjejnë punë që shfrytëzon potencialin e tyre dhe përmbushin qëllimet e tyre, ata janë më të motivuar dhe për këtë arsye më produktivë.

³ IAEVG International Conference 2023 ‘Life long Development as a standard’

- *Qëllimet e barazisë sociale*, duke përfshirë mbështetjen e mundësive të barabarta dhe promovimin e përfshirjes sociale. Shërbimet e këshillimit dhe edukimit për karrierë mund të rrisin aspiratat e grupeve të pafavorizuara dhe t'i mbështesin ata t'i arrijnë mundësitë që përndryshe mund t'u ishin mohuar.

Këshillimi dhe orientimi për karrierë mund të zbatohet si pjesë e kurrikulës, përmes qendrave të karrierës, virtualisht apo individualisht. (*lexo më shumë në Shtojcat për nivelet përkatëse të APU-së.*)

Politikat në fushën e këshillimit dhe orientimit për karrierë, krahas parimit të gjithëpërfshirjes ndërsektoriale, duhet të bazohet në parimet e cilësisë, të bazuara në standardet e cilësisë. Qëllimi i përgjithshëm i këtyre standardeve unifikon organizimin dhe funksionimin e këshilltarëve për karrierë në SHMU për krijimin e një sistemi unik të cilësisë në fushën e këshillimit dhe orientimit për karrierë për zhvillimin e shkathtësive të menaxhimit të karrierës. (*lexo më shumë te Shtojcat përkatëse*)

Agjenda evropiane e shkathtësive 2020 konfirmon nevojën për të mbështetur të gjithë individët në rrugën e tyre të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe thekson rëndësinë e shërbimeve të karrierës, veçanërisht në mjediset shkollore. Në përputhje me këtë agjendë, qeveria e Kosovës në programin e saj 2021-2025 dhe MASHTI në Strategjinë e Arsimit 2022-2026 në kuadër të prioriteteve ka përfshirë edhe zhvillimin dhe fuqizimin e shërbimeve të këshillimit dhe orientimit për karrierë.

Në kontekstin e Kosovës këshillimi dhe orientimi për karrierë bëhet edhe më i rëndësishëm, duke pasur parasysh procesin e tranzicionit në të cilin është duke kaluar, si dhe kushtet jo të favorshme të tregut të punës. Nxënësit kanë nevojë për një mbështetje për karrierë kur marrin vendime për përzgjedhjen e shkollimit, gjatë kalimit të tyre nëpër nivele të ndryshme të arsimit, apo gjatë tranzicionit nga shkolla në botën e punës.

4. ORIENTIMI NË KARRIERË NË SHMU NË KOSOVË

Në Kosovë kemi politika arsimore, strategji dhe ligje të cilat i referohen nevojës për shërbime të këshillimit dhe orientimit në karrierë në nivelin e SHMU:

- Kurrikula (Korniza Kurrikulare) e Arsimit Parauniversitar në Kosovë;
- Kurrikulat Bërthamë për SHMU;
- Ligji nr. 04/L-032 – 2011 për Arsimin Parauniversitar;
- Ligji nr. 04/L-143 – 2013 për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve;
- Ligji për Arsimin e Lartë (nr. 04/L-037), i referohet promovimit të mësimin tërëjetësor, ndërmarrësisë dhe krijimit të lidhjeve mes institucioneve të arsimit të lartë dhe bizneseve;

- Udhëzuesi i Agjencisë së Akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë (MASHT, 2013), kërkon që institucionet të vlerësohen për shërbimet e ofruara për studentët, duke përfshirë edhe shërbimet për karrierë;
- Plani strategjik për arsim të Kosovës (PSAK) 2022-2026 një prej prioriteteve është edhe harmonizimi i sistemit arsimor me kërkesat e tregut të punës.

“Në institucionet e SHMU, nxënësit përgatiten më thellësisht për orientim në karrierë duke u përkrahur me mentorë/këshilltarë profesionalë, të cilët orientojnë nxënësit në njohjen dhe zhvillimin e interesave të tyre personale për të nxënë dhe në përcaktimin përshtatshëm të pritshmërisë së tyre në të ardhmen”. *(lexoni më shumë te shtojcat relevante)*

Në Kosovë, së paku në pesë vitet e fundit ka pas përvoja të mira sa i përket aktiviteteve të karrierës. Në vitin 2018, MASHT ka lansuar platformën virtuale Busulla.com, e cila u ka shërbyer shkollave lidhur me të gjitha fushat e karrierës. Platforma është pasuruar me mbi njëmijë profesione dhe informata tjera lidhur me tregun e shkollimit dhe të punësimit. Bussulla.com është pjesë e kurrikulës shkollore, të fusha ‘jeta dhe puna’, prandaj të gjithë mësimitdhënësit e kësaj fushe janë trajnuar për shfrytëzimin e saj dhe mbështetjen e nxënësve se si ta përdorin. Më tutje, përmes projekteve në bashkëpunim me donatorët, janë realizuar përvoja të mira të aktiviteteve me nxënës sa i përket edukimit për karrierë: projekti i USAID ASSET/KEC, ka trajnuar mësimitdhënësit e 16 gjimnazeve me programin Këshillim dhe orientim në karrierë, për të cilët edhe ka hartuar doracakun për mësimitdhënësit, dhe në të njëjtat shkolla ka mbështetur themelimin e klubeve të karrierës nga nxënësit; projekti i GIZ/KCDF, ka mbështetur themelimin e klubeve të karrierës nga nxënësit në 20 SHMU; projekti SolidarSuisse/KCDF ka qenë i fokusuar në periudhën tranzitore të nxënësve nga klasa e 9-të në të 10-tën, dhe nga klasa e 12-të në tregun e punës, i zbatuar në SHMU-të e katër komunave (Pejë, Klinë, Istog dhe Deçan); ndërsa projekti EYE/KCDF ka zbatuar të njëjtin intervenim në SHMU edhe në tetë komuna të tjera (Gjakovë, Ferizaj, Vushtrri, Viti, Kaçanik, Prizren, Malishevë, Prishtinë).

Prandaj, MASHTI ka marrë iniciativën për institucionalizimin e shërbimeve të karrierës dhe rolin e këshilltarëve për karrierë në sistemin e arsimit parauniversitar në Kosovë. Është zhvilluar standardi i profesionit për këshilltarët e karrierës dhe validuar nga AKK. Sipas këtij standardi është zhvilluar programi kualifikues i nivelit të pestë, i cili është validuar nga AKK, si dhe programi ndërkombëtarë PEARSON, gjithashtu i nivelit të pestë.

Pozita e këshilltarit për karrierë është përfshirë në strukturën organizative të SHMU, të rregulluar me UA për menaxhimin e brendshëm të shkollave, si dhe është përfshirë në ligjin për pagat në sektorin publik.

5. STANDARDET MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLTARËVE PËR KARRIERË NË SHMU

Faktor i rëndësishëm për ofrimin cilësor dhe të qëndrueshëm të shërbimeve të orientimit në karrierë në SHMU është një strukturë e dakorduar e standardeve mbi organizimin dhe funksionimin e këshilltarëve për karrierë, me një mandat të qartë të tyre të rregulluar me legjislacion sekondar dhe udhëzime tjera relevante. Kjo do të siguronte burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare të mbështetura nga udhëheqja e shkollës dhe komuna, si dhe përgjegjësi të definuara të të gjitha palëve të interesit.

Në vazhdim janë paraqitur standardet dhe kërkesat minimale për organizimin dhe funksionimin e Këshilltarëve për Karrierë në SHMU të ndara në pesë kapituj:

6. Misioni dhe objektivat;
7. Roli i Këshilltarëve për Karrierë;
8. Angazhimi dhe funksionimi i Këshilltarëve për Karrierë në IAP;
9. Hapësirat dhe pajisjet e nevojshme për punën e Këshilltarëve për Karrierë;
10. Monitorimi dhe vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë.

Standardi 1 - Misioni dhe objektivat

Emërtimi	Misioni dhe objektivat e Këshilltarëve për Karrierë
Qëllimi	Misioni dhe objektivat janë thelbësore për KK-të për të ofruar shërbime të fokusuara në nevojat dhe kërkesat e shkollës, nxënësve dhe për t'i shtuar vlerë zhvillimit të komunitetit lokal. Misioni dhe objektivat mund të ndryshojnë lehtësisht ndërmjet KK-ve, varësisht nga specifikat e mjedisit ku gjendet shkolla, mundësive të vazhimit të shkollimit në nivel më të lartë, kushteve teknologjike në dispozicion, etj. Por, është e rëndësishme dhe e përbashkët për të gjithë KK-të, t'i zhvillojnë shërbimet dhe t'i përcjellin reformat në sistemin arsimor në Kosovë.
Kërkesat	Më poshtë janë paraqitur misioni, objektivat strategjike dhe objektivat operacionale që çdo KK duhet t'i përmbushë.

MISIONI

KK-të në SHMU kanë për qëllim që të sigurojnë që çdo nxënës të arrijë potencialin e tij të plotë në jetë, duke u shkolluar në drejtim shkollor adekuat apo aftësuar në profesionin përkatës, i motivuar dhe të njoh ofertat për shkollim dhe punë.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Te shkollat e mesme të ulëta (SHMU) Këshilltarët e karrierës (KK) do të:

- Mbështesin nxënësit e klasëve 6-9 me aktivitete të ndryshme në fazat e edukimit për karrierë. KK-të nuk e luajnë rolin e njëjtë si të mësimdhënësit të fushës ‘jeta dhe puna’, por, duhet të njohin planprogramin e tyre dhe të ndërlidhin temat dhe konceptet sipas nivelit të nxënësve;
- Mbështesin fazën tranzitore të nxënësve nga kl. 9-ta në SHML, duke ofruar informacione dhe këshilla;
- Bashkërendojnë aktivitetet ndërmjet SHMU dhe SHML në periudhën e aktivitetit ‘dyert e hapura’ ku do të përfshihen të gjithë nxënësit e kl të 9-ta;
- Bashkëpunojnë nga afër me prindërit e nxënësve të kl të 9-ta përmes sesioneve vetëdijësuese për aspekte të ndryshme të vazhimit të shkollimit të fëmijëve të tyre;
- Mbështesin mësimdhënësin mentor në procesin e themelimit dhe mentorimit të klubit të karrierës të nxënësve.

OBJEKTIVAT OPERACIONALE

Planet e punës së KK-ve që janë në shërbim në SHMU, duhet të ndërlidhen ngushtë me të priturat nga dokumentet kurrikulare, trendet e shkollimit, tregun lokal dhe global. Objektivat operacionale të punës së KK-ve duhet të ndërlidhen

ngushtë me planet zhvillimore të shkollës – afatshkurta dhe afatmesme. Ato plane do të jenë më specifike dhe ndryshohen dhe adaptohen varësisht nga nevojat e shkollës/nxënësve.

Objektivat afatshkurtra gjatë një viti shkollor:

- Ofron informata mbi karrierën (nxënësve, mësime, prindërve): informatat për edukimin në karrierën; aplikojnë parimet etike nëpërmjet rolit vetjak;
- Udhëzon grupet e nxënësve lidhur me resurset e informimit dhe mjetet e vetëvlerësimit; ndihmojnë nxënësit që të zhvillojnë plane individuale të veprimit;
- Vlerëson karakteristikat e individit lidhur me karrierën (përdor intervistat, mjetet për vlerësim dhe vetëvlerësim);
- Avokon për nxënësin (me qëllim të sistemimit të nxënësve të marginalizuar në trajnime, praktika të ndryshme, apo punësim);
- Mbështetë kurrikulën e karrierës në shkollë (mbështetë mësime, mësime në të kuptuarit e zhvillimit të karrierës);
- Aplikon rregulloret për siguri dhe mbron mjedisin (aplikon rregullat e higjienës personale dhe sigurisë në punë dhe zbaton praktikën e mirë ekologjike);
- Përgatit procedurat, shabllonet e punës, bazat e të dhënave, mjetet dhe instrumentet e punës, etj.;
- Promovon shërbimet për karrierë në komunitetin lokal;
- Identifikon partneritete të mundshme dhe nënshkruan marrëveshje të bashkëpunimit;
- Përgatit plane në bashkëpunim me SHMU-të tjera në komunën e tyre, për organizimin e aktiviteteve me nxënësit e klasave të 9-ta.

Objektivat afatmesëm / 1-3 vjet:

	<ul style="list-style-type: none"> • Ofron këshillim individual për karrierën (nëse posedon nivelin e kualifikimit 6 apo 7 të KKK); mëson nxënësit lidhur me procesin e vendimmarrjes në karrierë, për rëndësinë e krijimit të portfolios; për planet individuale për karrierë; • Ndërmjetëson për nxënësin (identifikon vende të shkollimit, shkathtësitë e nxënësve, mundësi të praktikave, punëve vullnetare, etj.); • Përcjellë nxënësit (mban evidencat e nxënësve që kalojnë në shkollim të mëtejshëm, apo gjejnë ndonjë punë - sipas ligjit të punës, etj. dhe ofron informata kthyesë SHMU-së, lidhur me cilësinë dhe efektin e shërbimit të edukimit të karrierës); • Ofron udhëzim për njohjen e mësimit paraprak-NJMP (njofton nxënësit për procesin e NJMP dhe të drejtës për ankesë); • Përkrah shërbimet e orientimit në karrierë (freskon dhe krijon material informuese, rrjetëzimin, promovimin e shërbimeve të edukimit në karrierë); • Monitoron dhe përmirëson praktikën e veta (mirëmban dhe zhvillon vazhdimisht njohuritë e veta personale, shkathtësitë dhe praktikën në edukim për karrierë).
--	--

Standardi 2 – Roli i Këshilltarëve për Karrierë

Emërtimi	Roli i Këshilltarëve për Karrierë
Qëllimi	KK-të do të ofrojnë shërbime për nxënësit e klasave 6-9, mësuesit, me një fokus të periudha tranzitore nga kl 9-të te kl 10-të, prindërit dhe komunitetin në përgjithësi.

Kërkesat

Paketa minimale e shërbimeve që KK-të duhet të ofrojnë, ndahet sipas grupeve të synuara:

C. BASHKËPUNIMI ME NXËNËSIT**A.1. Nxënësit e SHMU**

- Edukimi për karrierë për të gjithë nxënësit e SHMU-së duhet të ndihmojë ata të zhvillojnë shkathtësitë që nevojiten për të vlerësuar shtigjet e mundshme të karrierës;
- Nxënësit duhet mbështetur në arritjen e të priturve kurrikulare të lidhura me konceptet e karrierës, gjatë periudhës së zhvillimit të tyre të mëtejshëm, përfundimit dhe orientimit;
- Mbështetja e nxënësve bëhet duke pasur parasysh temat mësimore të lidhura me karrierën, te klasat 6 - 9 dhe të ndërtohet më tutje mbi ato tema;
- Mbështetja e nxënësve në themelimin e klubit të karrierës dhe këshillimi i mësimdhënësitor mentor të klubeve.

Lexo më shumë te Shtojca relevante.

Informacionet dhe burimet për karrierën:

- KK-të duhet të përgatisin dhe përditësojnë rregullisht një sërë informacionesh dhe materialesh të vlefshme për të mbështetur nxënësit në marrjen e informacionit sa më të saktë dhe relevant për zgjedhjen e karrierës së tyre;
- KK-të duhet të udhëzojnë dhe mbështetë mësimdhënësitor dhe nxënësit në përdorimin e platformës kombëtare Busulla.com - platformë unike për informim, edukim, këshillim dhe orientim për karrierë.

Shih Shtojcën 2 për informacion shtesë.

Ngritja e shkathtësive të buta për karrierë dhe punësueshmëri:

- KK-të duhet të ofrojnë trajnime grupore për nxënësit/vijuesit, si dhe konsultime individuale sipas nevojës, për ngritjen e shkathtësive të buta për zhvillim dhe menaxhim të karrierës dhe punësueshmërisë;
- Ky program trajnimi komplimenton temat e zhvilluara në kuadër të Edukimit për Karrierë.

Shih Shtojcën 3 për informacion shtesë.

Organizimi dhe pjesëmarrja në ngjarje:

- KK-të në bashkëpunim me SHML (shkollat profesionale dhe gjimnazet) duhet të organizojnë pjesëmarrjen e nxënësve të kl. 9-ta të paktën në një panair të edukimit dhe karrierës për vit shkollor dhe në aktivitetet e dyerve të hapura;
- KK-të janë përgjegjës të zhvillojnë kalendarin e aktiviteteve për vajza (p.sh. dita e vajzave, vajzat në TIK, mysafir folës nga gra të suksesshme në karrierë, etj.) dhe grupet minoritare (p.sh. dita e ndërmarrësisë për të fuqizuar vullnetin e tyre për shkollim dhe punësueshmëri) dhe t'i realizojë ato në bashkëpunim edhe me akterë tjerë relevant (p.sh. zyra komunale për minoritete, organizata rinore, etj.);
- Të zbatohen aktivitete për nxënësit /vijuesit me nevoja të veçanta.
- Të dizajnohet metodologjia për matjen e kënaqshmërisë së klientëve.
- Mirëmbajtja dhe përdorimi i Sistemeve Digjitale, duke ndjekur udhëzimet administrative dhe rregulloret e tjera përkatëse të parashikuara nga MASHTI, Komuna dhe SHMU-të. Sistemi i mëposhtëm është minimumi që KK-të duhet të përdorin:
 - Sistemi për gjurmimin e nxënësve pas klasës 9-të.

A.2. Nxënësit e ardhshëm (nga shkolla fillore në SHMU)

- Është e rekomandueshme që KK-të në SHMU të kërkojnë portfoliot e nxënësve që vijnë nga klasa e 5-të, të cilat i kanë plotësuar mësimdhënësit klasor dhe vet nxënësit gjatë klasave 1-5.
- Punojnë me nxënës që braktisin shkollën për informim dhe mbështetje për karrierë.

D. BASHKËPUNIMI ME KOMUNITETIN

- KK-të, duhet të krijojnë partneritete me prindërit, palë të ndryshme me interes, duke nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit apo marrëveshje të vullnetit të mirë.
- KK-të, duhet të bashkëpunojnë së paku me partnerët e mëposhtëm:
 - Komuna:
Ato mund të ftohen të marrin pjesë në ngjarje të karrierës; ato mund të ndihmohen në organizimin e ngjarjeve të komunitetit lokal duke i promovuar ato në mesin e nxënësve apo duke ofruar vullnetarë, etj.
 - Organizatat e biznesit në nivel lokal dhe qendror:
Ato mund të ftohen të marrin pjesë në ngjarje të karrierës dhe sesione të ndryshme për të ofruar informacione për tregun e punës.
 - OJQ-të, organizatat rinore: Ato promovojnë iniciativa përkatëse që mund të jenë të dobishme për nxënësit;
 - Prindërit dhe Këshillin e Prindërve: Mund të ftohen në ngjarje të karrierës dhe aktivitete tjera të shkollës;
 - Organizatat donator: KK-të mund të marrin pjesë në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve ose iniciativave të financuara nga donatorët që i shtojnë vlerë shërbimeve të karrierës.

	<ul style="list-style-type: none"> • Rrjetëzimi i KK-ve – shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira dhe bashkëpunimi për të zhvilluar shërbime, materiale dhe informacione të karrierës.
--	---

Standardi 3 – Angazhimi dhe funksionimi i Këshilltarëve për Karrierë në SHMU

Emërtimi	Angazhimi dhe funksionimi i Këshilltarëve për Karrierë në SHMU
Qëllimi	Përcaktimi i numrit dhe funksionit të KK-ve të angazhuar varësisht nga numri i nxënësve në SHMU.
Kërkesat	<p>Numri i Këshilltarëve për Karrierë</p> <p>Të gjitha SHMU përfitojnë shërbime nga KK-të. Numri i KK-ve përcaktohet varësisht nga numri i nxënësve në SHMU, siç është specifikuar në kategoritë e mëposhtme.</p> <p>1. Në SHMU deri në 500 nxënës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.1. Një KK me normë të plotë për bashkëpunim me nxënës, mësimdhënës dhe komunitetin, për tërë shërbimet/aktivitetet që ofrohen; 1.3. KK mund të angazhohet për më shumë se një SHMU në të njëjtën komunë, por jo të shërbejë më shumë se 500 nxënës gjithsej; 1.4. Nëse pozita e KK-së nuk mbulohet me normë të plotë, atëherë me propozim të SHMU-së, DKA plotëson këtë normë të plotë me dy gjysmë norma;

1.5. Norma e plotë për KK është e njëjtë si e punëtorëve profesional.

2. Në SHMU me 501 deri në 1000 nxënës:

2.1. Dy KK me norma të plota për bashkëpunim me nxënës, mësimdhënës dhe komunitetin;

2.2. KK-të mund të angazhohen për më shumë se një SHMU në të njëjtën komunë, por jo të shërbej më shumë se 1000 nxënës gjithsej;

2.4. Nëse dy pozitat e KK-ve nuk mbulohen me norma të plota, atëherë me propozim të SHMU-së, DKA plotëson këto dy norma të plota me gjysmë norma;

2.5. Norma e plotë për KK është e njëjtë si e punëtorëve profesional.

3. Në SHMU me mbi 1000 nxënës:

3.1. Dy KK me norma të plota për bashkëpunim me nxënës, mësimdhënës dhe komunitetin;

3.3. KK-të i shërbejnë vetëm një SHMU;

3.4. Nëse dy pozitat e KK-ve nuk mbulohen me norma të plota, atëherë me propozim të SHMU-së, DKA plotëson këto dy norma të plota me gjysmë norma;

3.5. Norma e plotë për KK është e njëjtë si e punëtorëve profesional.

Funksioni /pozita e Këshilltarëve për Karrierë

KK-të mund të jenë personel mësimdhënës që funksionojnë në kuadër të SHMU-së, nëse e plotësojnë kushtin që të kenë diplomën e kualifikimit për këshilltarë karriere.

KK-të janë pjesë e skemës organizative të SHMU-së në kuadër të Këshillit Profesional sipas UA për menaxhimin e brendshëm të shkollave.

KK-të me propozim të SHMU-së përzgjidhen nga DKA sipas përshkrimit të detyrave dhe kompetencave.

KK-të pajisen me kontratë nga DKA-të, me kohë të pacaktuar me orar të plotë si punëtorët profesional, ose si mësimdhënës (te rastet kur KK-të janë me gjysmë norme).

Kualifikimi dhe shkathtësitë e Këshilltarëve për Karrierë

Sipas standardeve ndërkombëtare, rekomandohet që KK të posedojnë kualifikimin 6 apo 7 të KKK (ekuivalent me Bachelor apo Master). Në Kosovë, derisa nuk kemi shkollim akademik të këtyre niveleve, për SHMU KK-të duhet të certifikohen me programin kualifikues të nivelit 5-të për këshilltarët e karrierës, sipas kualifikimit Pearson.

Shih Shtojcën 4 për informacion shtesë.

Raportimi i Këshilltarëve për Karrierë

- KK-të raportojnë sipas hierarkisë në skemën organizative të SHMU-së;
- Për punën e KK-ve, drejtori i SHMU-së raporton në DKA, siç raporton edhe për punën e mësimdhënësve të tjerë.

Standardi 4 - Hapësirat dhe pajisjet e nevojshme për punën e Këshilltarëve për Karrierë

Emërtimi	Hapësirat dhe pajisjet e nevojshme për punën e Këshilltarëve për Karrierë
Qëllimi	Përcaktimi i hapësirave dhe pajisjeve të punës të nevojshme për ofrimin cilësor të shërbimeve të karrierës.

<p>Kërkesat</p>	<p>Hapësirat e punës për Këshilltarët për Karrierë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hapësirat e punës duhet të jenë brenda SHMU-ve për të formuar një mjedis të këndshëm që stimulon funksionimin efektiv të punës së KK-ve. • Duhet të kenë sinjalistikë shumë të dukshme në mënyrë që të identifikohen lehtësisht nga vizitorët. <p>Hapësirat dhe sipërfaqet e obligueshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Një zyrë me sipërfaqe 15-25m²; • Shkolla duhet të sigurojë një hapësirë/klasë për organizimin e aktiviteteve të KK, me ndriçim natyral dhe mundësi për ajrosje natyrale, me perde për mbrojtje nga dielli (nëse ka nevojë) dhe kondicioner për ftohje/ngrohje; • Qasja në këto dy hapësira duhet të jetë e përshtatshme për persona me vështirësi në lëvizje, gjithashtu nga ana e jashtme të jetë në dispozicion pjerrina e përshtatshme për persona që lëvizin me karroca; • Qasja e lehtë në nyjën sanitare. <p>Mobileria e nevojshme për hapësirat e punës dhe ofrimin cilësor të shërbimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zyra duhet të ketë se paku një tavolinë pune dhe karrige dhe dy ulëse për vizitor, dollap për materiale promovuese të karrierës; • Salla mund të ketë një tavolinë të madhe rrethore ose disa tavolina më të vogla të cilat mund të ofrojnë fleksibilitet në organizim, 26 karrige, një TV ekran me mundësi të lidhjes me kompjuter, raftë dhe dollapë në muret anësore të pajisur me shumë materiale për edukim në karrierë; • Disa varëse për pallto për pjesëmarrësit. <p>Pajisjet teknologjike:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Laptop për secilin KK; • 1 printer multifunksional (printer, fotokopje, skaner); • 1 PC që mund të përdoret për të instaluar sistemet digjitale të punës dhe për t'u përdorur si databazë;
------------------------	--

- | | |
|--|---|
| | <ul style="list-style-type: none">• disa PC për përdorim të grupeve të cilët kanë nevojë për këshillime individuale;• 1 TV ekran i rrafshët. |
|--|---|

Lidhja me rrjetin dhe internetin:

Internet cilësor me kabëll apo wireless.

Standardi 5 - Monitorimi dhe vlerësimi i Këshilltarëve për Karrierë

Emërtimi	Monitorimi dhe vlerësimi i Këshilltarëve për Karrierë
Qëllimi	Përcaktimi i kushteve dhe kritereve për monitorim dhe vlerësim të këshilltarëve për karrierë në përmbushjen e objektivave dhe rezultateve.
Kërkesat	<p>Vlerësimi i objektivave strategjike:</p> <p>Bëhet çdo 3 vjet, nga drejtori i SHMU-së në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin mësimor, Këshillin profesional në shkollë, në bashkëpunim me KK-të, i cili raporton në DKA dhe sipas kërkesës edhe në MASHTI.</p> <p>Vlerësimi i objektivave operacionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> • KK-të hartojnë planin vjetor të punës për SHMU-të përkatëse më së voni në gusht për vitin e ri shkollor. Plani aprovohet nga këshilli mësimor dhe drejtori i shkollës; • Raportin e progresit të planit vjetor të punës e harton KK; • Vlerësimi i raportit të progresit bëhet nga drejtori i SHMU-së. <p>Vlerësimi i progresit të Planit Vjetor të Punës bëhet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në vitin e parë të angazhimit të KK-ve, dy herë në vit, pas gjymëvjektorit të parë dhe pas gjysmëvjektorit të dytë të vitit shkollor; • Pas vitit të parë, një herë në vit pas përfundimit të vitit shkollor. <p>Vlerësimi i rezultateve:</p>

KK-të planifikojnë rezultatet e pritshme bazuar në Planin Vjetor të Punës. Monitorimi i rezultateve bëhet vazhdimisht nga KK-të sipas treguesve të mëposhtëm:

- Numri i punëtorive/sesioneve informuese/trajnimeve të organizuara sipas temave;
- Numri i nxënësve të përfshirë në punëtori/sesione informuese/trajnime sipas klasave dhe të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike;
- Numri i nxënësve të mbështetur për punësim sipas klasave dhe të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike;
- Numri i nxënësve të përgatitur me shkathhtësitë e buta për realizim të suksesshëm të punës vullnetare apo praktikave në biznese;
- Numri i ngjarjeve të organizuara;
- Numri i nxënësve që ndoqën ngjarjet sipas klasave dhe të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike;
- Numri i bizneseve unike⁴ që bashkëpunojnë me KK-të.

Raportin mbi rezultatet e arritura e harton KK dhe e vlerëson drejtori i SHMU-së si në vijim:

- Në vitin e parë të angazhimit të KK-ve, dy herë në vit, pas semestrit të parë dhe pas semestrit të dytë të vitit shkollor;
- Pas vitit të parë të angazhimit të KK-ve, një herë në vit pas përfundimit të vitit shkollor.

Sigurimi i cilësisë

KK-të përdorin sistemin e brendshëm të monitorimit të kënaqshmërisë së klientëve me shërbimet e ofruara dhe aktivitetet e realizuara, për:

- Nxënësit e SHMU-së;
- Nxënësit e ardhshëm (nga shkolla fillore);

⁴ Numri i bizneseve unike nënkupton bizneset që regjistrohen në databazë njëherë, dhe jo sa herë të angazhohen në aktivitete të ndryshme

- | | |
|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none">• Bizneset;• Prindërit /Anëtarët e komunitetit. |
|--|--|

KK-të përdorin sistemin e gjurmimit të nxënësve që kanë përfunduar SHMU për secilin individualisht, bazuar në SMIA.

4. SHTOJCAT PËR SHMU

Shtojca 1. Edukimi për karrierë

Edukimi për karrierë mund të zbatohet sipas modeleve të ndryshme:

- **Si pjesë e kurrikulës** (përmes një fushe/lënde mësimore apo përmes të gjitha lëndëve, si çështje ndërkurrikulare, përmes aktiviteteve të klubeve të karrierës, etj.);
- **Përmes Qendrave/Zyrave të Karrierës** (mund të jenë me bazë në shkollë, apo në nivel lokal/qendror);
- **Modeli individual** (sipas interesave dhe mundësive të individit);
- **Modeli virtual** (platformat simuluese për informim, këshillim dhe orientim – busulla.com).

Në sistemin e arsimit parauniversitar në Kosovë, edukimi për karrierë adresohet përmes hierarkisë së dokumenteve kurrikulare: politikave arsimore (Korniza e kurrikulit – Kurrikula e Kosovës) dhe dokumenteve operacionale të arsimit (Kurrikulat bërthamë për nivele arsimore, Shkallëve kurrikulare, dhe kurrikulat e fushave/lëndëve mësimore). Kjo hierarki e dokumenteve kurrikulare krijon sistemin e rezultateve të të nxënit, të cilat ndihmojnë të përcaktohet edhe kualifikimi për ofruesit e shërbimeve të edukimit në karrierë.

<u>Hierarkia e dokumenteve të kurrikulumit</u>	<u>Sistemi i rezultateve të të nxënit</u>
KORNIZA E KURRIKULIT TË KOSOVËS	<u>Rezultatet kryesore të të nxënit që shprehin nivelin e domosdoshëm të arritshmërisë së gjashtë kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të arsimit parauniversitar</u>
KURRIKULI BËRTHAMË PËR SHKALLËT E KURRIKULUMIT 1 - 6	<u>Rezultatet esenciale të të nxënit që shprehin nivelin e domosdoshëm të arritshmërisë së gjashtë kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të çdo shkalle të kurrikulit</u>
	<u>Rezultatet e të nxënit për secilën fushë të kurrikulit gjatë një shkalle të kurrikulare</u>
PLAN-PROGRAMET LËNDORE	<u>Rezultatet e të nxënit sipas lëndëve, për secilën klasë</u>

Për realizimin e edukimit në karrierë si pjesë e kurrikulës, janë përgjegjës mësimdhënësit e të gjitha fushave mësimore, por në veçanti të fushës ‘jeta dhe puna’. Kjo bëhet përmes një orari të strukturuar mirë gjatë një viti shkollor, ku realizohen rezultatet e pritura nga secila fushë/lëndë, monitorohen dhe vlerësohen. Ndërsa, me futjen e pozitës së Këshilltarit të karrierës nëpër institucionet shkollore, përcaktohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj gjatë një viti apo disa viteve shkollore. Detyra e KK-ve është që të mbështesin menaxhmentin shkollor, mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit. Kjo duhet të bëhet në bazë të një plani të strukturuar dhe të monitoruar rregullisht.

Në secilin nivel shkollor, KK-të do të përkujdesen që nxënësit të ekspozohen në tri fushat e edukimit për karrierë:

- I/ Zbulimi dhe të kuptuarit e vetvetes
- II/ Perceptimi i mundësive në botën e edukimit dhe punës
- III/ Krijimi dhe menaxhimi i karrierës.

Te SHMU: Pritet që nxënësit të kalojnë nga shkalla e parë (përvetësim themelor) dhe e dytë (përfundim dhe zhvillim), nëpër shkallët kurrikulare tretë dhe të katërt të cilat do të bëjnë:

- Zhvillim i mëtejshëm dhe orientim
- Përfundim dhe orientim.

Në përputhje me këto përgjegjësi, dokumentet kurrikulare përcaktojnë sistemin e rezultateve të pritura që të realizohen nga mësimdhënësit, më specifiku te fusha kurrikulare 'jeta dhe puna'. Këto koncepte patjetër se duhet të ndërliken në formë të kontinuitetit nga shkolla fillore, duke filluar nga shkalla kurrikulare 1 dhe 2, kur mësimdhënësit klasor ofrojnë konceptet e karrierës përmes lëndës 'Shkathtësi për jetë, Punëdore dhe Ekonomi shtëpiake'. Në nivelin e SHMU, nëpër shkallët kurrikulare 3 dhe 4, përgjegjësinë më të madhe për konceptet e karrierës e kanë mësimdhënësit e fushës mësimore 'jeta dhe puna', e cila përveç koncepteve të edukimit për karrierë e përfshin edhe TIK-un, edukimin për ndërmarrësi dhe edukimin e qëndrueshëm.

KK-të, duhet të mbështesin personelin mësimor në realizimin e koncepteve të karrierës. Përtej kësaj, ata do të planifikojnë dhe realizojnë aktivitete shtesë me të gjithë nxënësit e klasave 6-9, me tema të ndryshme që i përkasin karrierës (organizojnë teste të ndryshme grupore, ofrojnë burime të ndryshme-online apo kopje fizike të informacioneve për profesionet dhe këshillojnë lidhur me kërkesat e tregut të punës).
Lexo më shumë te Shtojca 4.

Shtojca 2. Informacionet dhe burimet për karrierën

Te SHMU, Këshilltarët për Karrierë dhe mësimdhënësit e fushës 'jeta dhe puna', shfrytëzojnë platformën nacionale Busulla.com që të vlerësojnë dhe informojnë nxënësit për mundësitë e shkollimit të mëtejshëm në SHML. Organizojnë vizita nëpër gjimnaze dhe shkolla profesionale, bisedojnë për nevojat e tregut dhe mundësitë e profesioneve të ndryshme në tregun aktual vendor dhe më gjerë.

Këshilltarët për Karrierë planifikojnë aktivitetet vjetore lidhur me ofrimin e informacioneve për karrierën, duke përfshirë punëtoritë, sesionet informuese, panairët e karrierës, prezentimet e punëdhënësve ose ngjarje të tjera. Në këto aktivitete përfshihen nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit.

Këshilltarët për Karrierë ofrojnë materiale informuese të printuara apo elektronike sipas nevojës.

Shtojca 3. Ngritja e shkathtësive të buta për karrierë dhe punësueshmëri

Realizimi i kurrikulit shkollor kërkon një qasje gjithpërfshirëse për të arritur qëllimin e plotë. Nëse analizojmë rezultatet e pritura kurrikulare nëpër nivele të ndryshme shkollore, mund të gjejmë se ato kryesisht adresojnë një pjesë të elementeve të kompetencave mësimore: *njohuritë/dijet, shkathtësitë dhe rutinat* e nxënësve. Por, edhe tri elemente tjera të rëndësishme të kompetencës mësimore mbetet të adresohen disi, e ato janë *qëndrimet, vlerat dhe sjelljet* e nxënësve. Përmes adresimit të këtyre elementeve të kompetencave mësimore, ne mund të

zhvillojmë pakon e nevojshme të shkathtësive të buta, të cilat krijojnë sistemin e vlerave të nevojshme për jetë, punësim apo vetëpunësim të nxënësve. Lista e shkathtësive të buta mund të jetë më e gjatë po më shkurtër dhe secili vend apo organizatë mund të krijojë një set të domosdoshëm/relevant të atyre shkathtësive. Është e njohur se shkathtësitë e buta mund të ndihmojnë menaxhimin e karrierës duke sjellë një sërë kompetencash që u mundësojnë individëve dhe grupeve të kenë një mënyrë të strukturuar për mbledhjen, analizimin, unifikimin dhe organizimin e të dhënave personale, arsimimin dhe punësimin si dhe shkathtësitë e tranzicionet drejt vendimmarrjes.

Disa nga shkathtësitë e buta që ndikojnë shumë në edukim të karrierës janë:

- **Të menduarit kritik dhe kreativ:**

Mendimi kritik përshkruhet si një shkathtësi për të pyetur, për të provuar supozimet e ngritura, për të njohur paqartësitë, për të interpretuar, vlerësuar e gjykuar. Mendimi kritik është proces i të menduarit reflektues dhe të arsyeshëm. Kreativiteti është aftësia për të parë gjërat ndryshe dhe për të gjetur mënyra të reja për zgjidhjen e problemeve. Ai mund të shihet si një proces dhe/ose një produkt dhe përgjithësisht mendohet si prodhim i zgjidhjeve të dobishme për problemet.

- **Komunikimi efektiv:**

Shkathtësitë e komunikimit janë kritike dhe parashikuese të suksesit në karrierë dhe mirëqenies individuale. Komunikuesit efektiv i shprehin idetë e tyre me gojë apo me shkrim në mënyrë efikase dhe gjenerojnë e përpunojnë mesazhe në atë mënyrë që u mundëson atyre të realizojnë qëllimet e caktuara. Ata e vënë theksin në aftësitë ndërpersonale, përgjegjësinë personale, përgjegjësinë sociale dhe qytetare.

- **Zgjidhja e problemeve:**

Shkathtësia për zgjidhjen e problemeve e një individi paraqet gatishmërinë për t'u përfshirë në situata problemore për të arritur potencialin e një personi si qytetar konstruktiv dhe reflektues. Kjo shkathtësi zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme duke e vendosur veten në situata të reja që kërkojnë zgjidhje dhe që mund të transferohen në kontekste të ndryshme.

- **Inteligjenca emocionale:**

Inteligjenca emocionale është kapaciteti për të arsyetuar emocionet dhe për të forcuar të menduarit. Ajo përfshin aftësitë për të perceptuar me saktësi emocionet, për të rifituar dhe gjeneruar emocione, për të ndihmuar të menduarit, të kuptuarit e njohurive për emocionet dhe për të rregulluarit në mënyrë reflektuese të emocioneve që promovojnë rritjen emocionale dhe intelektuale.

- **Këmbëngulësia:**

Këmbëngulja është vazhdimësia e përpjekjes dhe realizimit në mënyrë të plotë dhe të kujdesshme të një qëllimi të caktuar, ndërsa tejkaloni vështirësitë, pengesat ose dekurajimin e paparashikuar gjatë rrugës, duke ndryshuar planin tuaj të ndërhyrjes. Këmbëngulja mund të shihet edhe si një model vendimesh relativisht të qëndrueshme dhe angazhim për punë të madhe drejt arritjes së një qëllimi.

- **Puna ekipore:**

Puna ekipore mund të përkufizohet si punë e kryer nga një grup njerëzish të bashkuar për të realizuar një detyrë të veçantë me efikasitet më të madh sesa kur detyra kryhet pa bashkëpunim. Secili anëtar i ekipit bën një pjesë të detyrës dhe i nënshtrohet kërkesave të situatës në mënyrë që të nxjerrë përfitime personale për veten e tij duke bashkëpunuar me të tjerët. Një anëtar i ekipit duhet të bashkëveprojë me të tjerët, të arrijë pajtueshmëri, të jetë mbështetës, i dobishëm dhe bashkëpunues.

- **Ndërgjegjshmëria:**

Ndërgjegjësimi është një spektër i konstruksioneve që përshkruajnë dallimet individuale në tendencën për të qenë të vetëkontrolluar, përgjegjës ndaj të tjerëve, punëtorë, të rregullt dhe që i respektojnë rregullat. Ndërgjegjësimi parashikon arritjen më të lartë në shkollën e mesme dhe në studime, dhe është e pavarur nga aftësia kognitive.

- **Mbledhja e informatave:**

Shkathësitë për mbledhjen e informatave i referohen shkathësisë për të identifikuar burimet e të dhënave, mbledhjen dhe analizën e tyre me qëllim të zgjidhjes së problemeve të ndryshme. Këto shkathësi e bëjnë një individ të jetë i aftë që të përdorë teknologjinë si mjet për të hulumtuar dhe menaxhuar informacionet në mënyrë efikase. Është e rëndësishme që individi të jetë i aftë të vlerësojë cilësinë dhe rëndësinë e burimeve të informacionit dhe të jetë i vetëdijshëm për besueshmërinë e tyre.

Shkathësitë e buta mund të zhvillohen edhe gjatë procesit të rregullt mësimor prandaj, për të mos u përsëritur, KK-të dhe mësimdhënësit dakordohen për ndarjen e aktiviteteve në mes vete. KK-të duhet të ofrojnë trajnime grupore për nxënësit, si dhe konsultime individuale sipas nevojës, për ngritjen e shkathësisë për zhvillim dhe menaxhim të karrierës dhe punësueshmërisë.

Ky program trajnimi komplimenton temat e zhvilluara në kuadër të Edukimit për Karrierë.

Të gjithë nxënësit duhet gradualisht gjatë shkollimit të ekspozohen në zhvillimin e shkathësisë të buta, edhe pse mund t'u jepet prioritet klasave tranzitore, klasës 9-të dhe 12-të për t'i përgatitur ata për nivel tjetër arsimor apo qasje në tregun e punës dhe punësueshmëri.

Temat e trajnimit :

- Përgatitja e CV-së dhe letrës motivuese.
- Përgatitja për intervistë të punës.

- Hulumtimi për vende të punës dhe rishikimi i një oferte për punësim.
- Hulumtimi i shkollave të mesme të larta dhe programeve të tyre.
- Hulumtimi i programeve universitare dhe programeve trajnuese për arsim dhe aftësim të mëtutjeshëm dhe përgatitja për aplikim.
- Projekte jashtëmësimore për të zhvilluar shkathtësitë e buta tek nxënësit.
- Aktivitete tjera të lidhura me karrierën përfshirë mobilitetin e nxënësve, punën vullnetare dhe trajnime ekstra kurrikulare.

Shtojca 4: Përshkrimi i detyrave të Këshilltarëve për Karrierë- Informatë fillestare lidhur me resurset njerëzore

Personeli që punojnë në fushën e karrierës duhet të posedojnë pako të caktuar të kompetencave. Organizatat ndërkombëtare të cilat merren profesionalisht me karrierën, ndajnë tri lloje të kualifikimeve të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK), e cila është kompatible me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) në Kosovë. Këto tri kualifikime janë: Këshilltarë karriere, Praktikues karriere, Specialist karriere.

Këshilltarët e karrierës mund të jenë mësimdhënës, menaxherë të punësimit, psikolog, punëtorë social, etj. Këta nuk janë profesionist të karrierës, por profesionist të një fushe tjetër, të cilët ofrojnë një lloj të mbështetjes në karrierë, si plotësim i punës dhe funksionit tyre primarë. Por, janë në gjendje të ofrojnë mbështetje dhe këshilla bazë në nivel të besueshëm të cilësisë, dhe të kuptojnë nëse individë do të përfitojë nga shërbimi i tyre profesional. Ky kualifikim i takon nivelit 6 të KKK.

Praktikuesit e karrierës janë profesionist (këshilltarë karriere, këshilltarë të punësimit, mentorë të karrierës, këshilltarë shkollor, zhvillues të personelit, këshilltarë të edukimit ose udhëheqjes, etj.). Këta janë të përqendruar në fushën e edukimit për karrierë dhe këtë e shohin si profesion të tyre primar, për të mbështetur njerëzit gjatë sfidave komplekse të karrierës tyre. Janë të gatshëm të mbështesin individët të cilët ballafaqohen me pasiguri, probleme shumëplanëshe dhe situata të paparashikueshme. Ky kualifikim është kompetent të mbështesë zhvillime të qasjeve strategjike, të ofrojë qasje në njohuri shumë të specializuara, dhe ndihmojë klientët në ballafaqim me faza stresuese gjatë tranzicionit si dhe projekte të ndryshimeve personale. Ky kualifikim i takon nivelit 7 të KKK.

Specialistët e karrierës janë profesionist, të cilët marrin përgjegjësi më të gjerë për profesionin e karrierës dhe punojnë drejt avancimit në mënyra të ndryshme. Disa prej tyre fokusohen në çështje praktike (psh menaxhimin e shërbimeve të karrierës, politikbërjes ose të mbikëqyrjes së profesionistëve tjerë të karrierës, të dy niveleve të mëparshme). Të tjerët, mund të angazhohen në hulumtime dhe zhvillime ose trajnime akademike në fushën e edukimit për karrierë. Specialistët janë në gjendje të performojnë si praktikues karriere, të demonstrojnë autoritet substancial, integritet studiues dhe profesional të fokusuar në edukimin për karrierë. Ky kualifikim i takon nivelit 8 të KKK.

Pearson është program i nivelit të 5 të kualifikimeve.

Kushtet e përgjithshme

- KK-të raportojnë sipas hierarkisë në skemën organizative të institucionit ku veprojnë.
- Te SHMU, KK-të mund të jenë mësimdhënës të cilët kanë të përfunduar programin kualifikues PIRSON.
- Norma e punës për pozitën e KK-ve është e njëjtë si e punëtorëve profesional në SHMU.

Detyrat kryesore

Shërbimet për nxënësit dhe mësimdhënësit e SHMU-së

- Sipas standardit 1, objektivat strategjike dhe operacionale
- Sipas standardit 2, pika A.1

Shërbimet për nxënësit e ardhshëm

- Sipas standardit 2, pika A.2.

Shërbimet për komunitetin

- Sipas standardit 2, pika B.

Punët administrative

- Zhvillimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për nxënës, akterë nga komuniteti dhe palë tjera të interesit.
- Mirëmbajtja dhe përditësimi i kanaleve mediale sociale lidhur me aktivitetet e zhvilluara.
- Mbajtja e evidencës mbi aktivitetet e zhvilluara dhe mbështetja gjatë hartimit të raporteve të progresit.
- Mbikëqyrja e nxënësve vullnetarë që ndihmojnë KK-të.
- Mbajtja e shënimeve të sakta për aktivitetet dhe rezultatet (monitorimi dhe vlerësimi).

Marketingu dhe promovimi

- Promovimi i shërbimeve të karrierës për grupe të ndryshme të synuara nëpërmjet ngjarjeve të ndryshme, publikimeve, aktiviteteve online, etj.

- Promovimi i shërbimeve të karrierës përmes mediave sociale dhe mediave nacionale.
- Zhvillimi i publikimeve dhe materialeve promovuese.

Njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme

- Njohuri dhe shkathtësi për vendimmarrje
- Njohuri dhe shkathtësi për planifikim
- Shkathtësi komunikuese dhe prezentuese
- Shkathtësi për menaxhimin e kohës
- Shkathtësi për punë në ekip
- Njohuri dhe shkathtësi për zhvillim dhe mbajtje të trajnimeve
- Njohuri për rrjetëzim
- Shkathtësi për zgjidhje të problemeve dhe negocim
- Njohuri dhe shkathtësi digjitale
- Shkathtësi ndërmarrëse
- Njohje e gjuhëve të huaja (e dëshirueshme).



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit- Ministarstva za
Obrazovanje Nauku, Tehnologiju i Inovacija-Ministry of Education
Science, Technology and Innovation*

Standardet për organizimin dhe funksionimin e Këshilltarëve për Karrierë në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional

Qershor, 2023

Ky dokument është zhvilluar me mbështetjen e projektit “Rritja e Punësimit për të Rinj (EYE) i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) zbatuar nga konsorciumi Helvetas Swiss Intercooperation dhe Management Development Associates

Përmbajta

1. HYRJE.....	13
2. ORIENTIMI NË KARRIERË NË IAAP NË KOSOVË.....	14
3. STANDARDET MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLTARËVE PËR KARRIERË NË IAAP	15
Standardi 1 - Misioni dhe objektivat	15
Standardi 2 – Roli i Këshilltarëve për Karrierë	17
Standardi 3 – Angazhimi dhe funksionimi i Këshilltarëve për Karrierë në IAAP	22
Standardi 4 - Hapësirat dhe pajisjet e nevojshme për punën e Këshilltarëve për Karrierë	24
Standardi 5 - Monitorimi dhe vlerësimi i Këshilltarëve për Karrierë	26
4. SHTOJCAT	1
<i>Shtojca 1. Edukimi për karrierë</i>	<i>1</i>
<i>Shtojca 2. Informacionet dhe burimet për karrierën</i>	<i>2</i>
<i>Shtojca 3. Ngritja e shkathtësive të buta për karrierë dhe punësueshmëri</i>	<i>2</i>
<i>Shtojca 4: Përshkrimi i detyrave të Këshilltarëve për Karrierë</i>	<i>1</i>

Shkurtesat

AAAPARr	Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
CEDEFOP	Qendra Evropiane për Zhvillimin e Formimit Profesional
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
EYE	Rritja e Punësimit për të Rinj
IAAP	Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

MVP	Mësimi në Vendin e Punës
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës
QAP	Qendra e Aftësimi Profesional
QeK	Qendra e Kompetencës
KK	Këshilltarët për Karrierë

6. HYRJE

Përkufizimi i orientimit në karrierë, i miratuar në Rishikimin e Politikave të Orientimit në Karrierë të OECD-së⁵ përshkruan "shërbimet që synojnë të ndihmojnë njerëzit, të çdo moshe dhe në çdo moment gjatë jetës së tyre, për të bërë zgjedhjet mbi profesionin, arsimin dhe aftësimin, si dhe për të menaxhuar karrierën e tyre". Arsyet për vëmendje të politikëbërjes ndaj orientimit në karrierë si një e mirë publike dhe private ndahen në tre kategori kryesore:

- *Qëllimet e të nxënit*, duke përfshirë përmirësimin e efikasitetit të sistemit të arsimit dhe aftësimin dhe menaxhimin e ndërlidhjes së tij me tregun e punës. Nëse individët marrin vendime në një mënyrë të mirëinformuar dhe të menduar mirë, lidhur me interesat e tyre, kapacitetet dhe aspiratat e tyre, investimet në sistemet e arsimit dhe aftësimin japin përfitime më të larta.
- *Qëllimet e tregut të punës*, duke përfshirë përmirësimin e përputhjes ndërmjet ofertës dhe kërkesës dhe menaxhimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve. Nëse njerëzit gjejnë punë që shfrytëzojnë potencialin e tyre dhe përmbush qëllimet e tyre, ata janë më të motivuar dhe për këtë arsye më produktivë.
- *Qëllimet e barazisë sociale*, duke përfshirë mbështetjen e mundësive të barabarta dhe promovimin e përfshirjes sociale. Shërbimet e orientimit për karrierë mund të rrisin aspiratat e grupeve të pafavorizuara dhe t'i mbështesin ata t'i arrijnë mundësitë që përndryshe mund t'u ishin mohuar.

Ekziston një tendencë për të menduar se orientimi në karrierë është kryesisht i parëndësishëm për AAP-në, gjë që bazohet në supozimin se vendimet për karrierën tashmë janë marrë. Mirëpo ky supozim është argumentuar se është i mangët në një numër aspektesh të rëndësishme, dhe se orientimi për karrierë po vepron me efektivitet si një urë shtesë midis programeve të AAP-së dhe botës së punës, duke e parë nxënësin si një agjent aktiv në këtë marrëdhënie.⁶ Orientimi në karrierë është i rëndësishëm për cilësinë dhe efektivitetin e AAP-së në dy faza të ndryshme:

Përpara hyrjes në një program të AAP-së, bazuar në dy parime të rëndësishme:

- Që të gjithë të rinjtë duhet të ndërgjegjësohen për opsionet e AAP-së së bashku me opsionet e tjera të disponueshme për ta.
- Që të rinjtë e interesuar në opsionet e AAP-së të mbështeten me informacione të cilësisë së lartë për karrierën, për të siguruar që zgjedhjet e tyre janë të mirinformuara dhe të menduara mirë.

Në kuadër të programit të AAP-së, bazuar në dy parime të rëndësishme:

- Orientimi në karrierë duhet të jetë i disponueshëm në të gjitha pikat përkatëse të vendimmarrjes për zhvillimin e ardhshëm personal.

⁵ OECD, 2004

⁶ Punim kërkimor i Institutit Kombëtar për Edukim dhe Këshillim në Karrierë, Kembrixh, MB, shtator 2009: Marrëdhënia e Orientimit për Karrierë me AAP-në.

- Orientimi në karrierë duhet të përgatisë nxënësit si për mjediset e punës ashtu edhe për jetën e përditshme, ashtu që nxënësit të zhvillojnë kompetenca transversale të nivelit të lartë për të adresuar sfidat komplekse.

Agjenda evropiane e aftësive 2020, konfirmon nevojën për të mbështetur të gjithë individët në rrugën e tyre të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe thekson rëndësinë e shërbimeve të karrierës, veçanërisht në mjediset shkollore. Në përputhje me këtë agjendë, Qeveria e Kosovës në programin e saj 2021-2025 dhe MASHTI në Strategjinë e Arsimit 2022-2026, në kuadër të prioritetëve për harmonizimin e AAP-së, me kërkesat e tregut të punës ka përfshirë edhe zhvillimin dhe fuqizimin e shërbimeve të orientimit në karrierë në IAAP.

7. ORIENTIMI NË KARRIERË NË IAAP NË KOSOVË

Ligji nr. 04/L-138 – 2013 për AAP-në në Kosovë kërkon mbështetjen e zhvillimit të karrierës së nxënësve si pjesë e integruar e të mësuarit gjatë gjithë jetës (neni 3, pika 1.5), dhe orientimi në karrierë duhet të jetë pjesë integrale e të gjitha programeve të ofruara nga IAAP-të (neni 6, pika 3,3).

Përvojat në vendet e ndryshme të BE-së dhe në rajon tregojnë se shërbimet e karrierës në IAAP mund të organizohen në forma të ndryshme, si modeli kurrikular, modeli i qendrës për karrierë, modeli virtual, apo edhe kombinim i këtyre modeleve. Në Kosovë, që nga viti 2017, MASHTI në bashkëpunim me projektin EYE dhe akterët tjerë relevant ka zhvilluar modelin e Qendrës për Karrierë me bazë në shkollë i cili deri tani është zbatuar në 23 IAAP të ndryshme. Një vlerësim i kryer së fundmi mbi ndikimin e shërbimeve të ofruara nga qendrat e karrierës në IAAP në Kosovë⁷ tregon përfitime të prekshme për shkollat, nxënësit, punëdhënësit dhe komunitetin. Kështu që justifikohet nevoja për shërbime të karrierës në të gjithë sistemin e AAP-së në nivel vendi dhe krahas kësaj edhe përgatitja profesionale e mësimitdhënësve për të marrë rolin e këshilltarit për karrierë.

Prandaj, MASHTI ka marrë udhëheqjen për të institucionalizuar shërbimet e karrierës dhe rolin e këshilltarëve për karrierë për të gjithë sistemin e AAP-së në Kosovë. Është zhvilluar standardi i profesionit dhe programi kualifikues për këshilltarët e karrierës, të cilat u validuan nga AKK dhe aktualisht kemi 15 këshilltarët e parë të karrierës të certifikuar. Pozita e këshilltarit për karrierë është përfshirë në organogramin e IAAP-ve të rregulluar me UA për menaxhimin e brendshëm të shkollave, si dhe është përfshirë në ligjin për pagat në sektorin publik. Ndërsa, tani MASHTI themeloi grupin punues për të zhvilluar standardet për organizimin dhe funksionimin e këshilltarëve për karrierë në IAAP dhe t'i përdorë ato për të zhvilluar udhëzime të qarta administrative dhe legjislativonin përkatës sekondar.

Kuadri ligjor për AAP dhe arsimin e të rriturve bazohet në ligjet përkatëse kombëtare, siç janë renditur më poshtë:

- Ligji nr 04/L-032 – 2011 për Arsimin Parauniversitar

⁷ Raporti nga vlerësimi i shërbimeve dhe përfitimeve nga Qendrat e Karrierës në IAAP të realizuar nga projekti EYE në 2021

- Ligji nr. 04/L-138 – 2013 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional
- Ligji nr. 04/L-143 – 2013 për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve
- Ligji nr 03/L-060 – 2011 për Kualifikimet Kombëtare
- Ligji nr. 2004/37 – 2004 për Inspektoratin e Arsimit në Kosovë
- Ligji nr. 03/L-068 – 2008 për Arsimin në Komuna
- Ligji nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Kosovës.

Për zbatimin e kuadrit ligjor të lartpërmendur janë miratuar disa udhëzime dhe rregullore administrative përkatëse.

8. STANDARDET MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLTARËVE PËR KARRIERË NË IAAP

Faktor i rëndësishëm për ofrimin cilësor dhe të qëndrueshëm të shërbimeve të orientimit në karrierë në IAAP është një strukturë e dakorduar e standardeve mbi organizimin dhe funksionimin e këshilltarëve për karrierë, me një mandat të qartë të tyre të rregulluar me legjislacion sekondar dhe udhëzime tjera relevante. Kjo do të siguronte burime të njaftueshme njerëzore dhe financiare të mbështetura nga udhëheqja e shkollës dhe komuna, si dhe përgjegjësi të definuara të të gjitha palëve të interesit.

Në vazhdim janë paraqitur standardet dhe kërkesat minimale për organizimin dhe funksionimin e Këshilltarëve për Karriere në IAAP të ndara në pesë kapituj:

11. **Misioni dhe objektivat**
12. **Roli i Këshilltarëve për Karrierë**
13. **Angazhimi dhe funksionimi i Këshilltarëve për Karrierë në IAAP;**
14. **Hapësirat dhe pajisjet e nevojshme për punën e Këshilltarëve për Karrierë;**
15. **Monitorimi dhe vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë.**

Standardi 1 - Misioni dhe objektivat

Emërtimi	Misioni dhe objektivat e Këshilltarëve për Karrierë
-----------------	--

<p>Qëllimi</p>	<p>Misioni dhe objektivat janë thelbësore për KK-të për të ofruar shërbime të fokusuara në nevojat dhe kërkesat e nxënësve dhe për t'i shtuar vlerë zhvillimit të komunitetit lokal. Misioni dhe objektivat mund të ndryshojnë lehtësisht ndërmjet KK-ve pasi ata u shërbejnë IAAP-ve të ndryshme, por është e rëndësishme t'i zhvillojnë shërbimet dhe t'i përcjellin reformat në sistemin arsimor në Kosovë.</p>
<p>Kërkesat</p>	<p>Më poshtë janë paraqitur misioni, objektivat strategjike dhe objektivat operacionale që çdo KK duhet t'i përmbushë.</p> <p>MISIONI</p> <p>KK-të informojnë dhe mbështesin nxënësit/vijuesit e AAP-së dhe nxënësit e ardhshëm të përmirësojnë aftësitë dhe shkathtësitë për zhvillim dhe menaxhim të karrierës dhe në bashkëpunim të ngushtë me Koordinatorët për Mësim në Vendin e Punës (KMVP) të lehtësojnë tranzicionin e tyre nga shkolla në punë.</p> <p>OBJEKTIVAT STRATEGJIKE</p> <ul style="list-style-type: none"> • KK-të ofrojnë shërbime për nxënësit/vijuesit e tërë ciklit të AAP-së (klasat 10-11-12). • KK-të informojnë dhe mbështesin nxënësit e ardhshëm (nxënësit e klasës së 9-të dhe nxënësit që kanë braktisur shkollën) lidhur me vendimmarrjen për profesionin e tyre të ardhshëm dhe orientim dhe zhvillim në karrierë. • KK të bashkëpunojnë me KMVP-të për përgatitjen e nxënësve me shkathtësitë e buta për realizim të suksesshëm të MVP-së. • KK-të bashkëpunojnë me palë të ndryshme me interes për IAAP duke përfshirë edhe prindërit të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në vendimmarrjen e nxënësve për profesionin e tyre të ardhshëm. <p>OBJEKTIVAT OPERACIONALE</p>

	<p>Objektivat afatshkurtra 6-12 muaj:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi i kapaciteteve funksionale dhe operacionale: <ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja për një veprimtari fillestare (procedurat, shabllonet e punës, bazat e të dhënave, mjetet dhe instrumentet e punës, etj.) • Promovimi i shërbimeve për karrierë në komunitetin lokal • Planifikimi i përbashkët me KMVP-të për përgatitjen e nxënësve për realizim të suksesshëm të MVP-së. 2. Identifikimi i partneriteteve të mundshme dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit. 3. Përgatitja e planeve në bashkëpunim me shkollat e mesme të ulëta për organizimin e aktiviteteve me nxënësit e klasave të 9-ta. <p>Objektivat afatmesëm / 1-3 vjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ofrimi i shërbimeve të karrierës për nxënësit dhe komunitetin, të prioritizuara sipas kontekstit dhe nevojave të AAP-së. 2. Bashkëpunimi me partnerët dhe palët e interesit. 3. Rritja graduale e fushëveprimit të aktiviteteve.
--	---

Standardi 2 – Roli i Këshilltarëve për Karrierë

Emërtimi	Roli i Këshilltarëve për Karrierë
Qëllimi	KK-të duhet të ofrojnë shërbime për nxënësit/vijuesit e AAP-së, nxënësit e ardhshëm (nxënësit e klasës së 9-të dhe nxënësit që kanë braktisur shkollën), prindërit dhe komunitetin në përgjithësi.
Kërkesat	Paketa minimale e shërbimeve që KK-të duhet të ofrojnë, ndahet sipas grupeve të synuara:

E. BASHKËPUNIMI ME NXËNËSIT

A.1. Nxënësit/vijuesit e AAP-së

- Edukimi për karrierë për të gjithë nxënësit/vijuesit e AAP-së KK-të duhet t'i ndihmojnë nxënësit/vijuesit të zhvillojnë aftësitë që nevojiten për të vlerësuar shtigjet e mundshme të karrierës.

Shih Shtojcën 1 për informacion shtesë.

- Informacionet dhe burimet për karrierën

KK-të duhet të përgatisin dhe përditësojnë rregullisht një sërë informacionesh dhe materialesh të vlefshme për të mbështetur nxënësit/vijuesit në zgjedhjen e karrierës së tyre, si një mundësi për realizim profesional ose vazhdim të arsimit pas diplomimit. Informacioni duhet të jetë i përshtatshëm për profilet në IAAP. Përdorimi i platformës kombëtare Busulla.com është i domosdoshëm për këtë qëllim.

Shih Shtojcën 2 për informacion shtesë.

- Ngritja e shkathtësive të buta për karrierë dhe punësueshmëri.

KK-të duhet të ofrojnë trajnime grupore për nxënësit/vijuesit, si dhe konsultime individuale sipas nevojës, për ngritjen e shkathtësive për zhvillim dhe menaxhim të karrierës dhe punësueshmërisë.

Ky program trajnimi komplimenton temat e zhvilluara në kuadër të Edukimit për Karrierë.

Prioritet duhet t'u jepet klasave të 12-ta për t'i përgatitur ato për qasje në tregun e punës dhe punësueshmëri.

Shih Shtojcën 3 për informacion shtesë.

- Mbështetja e nxënësve/vijuesve dhe të diplomuarve për të gjetur mundësi punësimi konform Ligjit të Punës në fuqi.

- Organizimi i ngjarjeve

KK-të në bashkëpunim me KMVP-të duhet të organizojnë të paktën një panair të punës dhe karrierës për vit shkollor, për të tërhequr të gjitha bizneset relevante në nivel lokal dhe nga rajonet tjera, institucionet e arsimit të lartë, ofrues të trajnimeve, si dhe pjesëmarrës tjerë të mundshëm si zyrat lokale të punësimit, OJQ, qendra rinore, etj.

KK-të gjithashtu janë përgjegjës për organizimin e ngjarjeve tjera të lidhura me zhvillim të karrierës së nxënësve/vijuesve të AAP-së, të tilla si prezentime ose seminare të ofruara nga bizneset ose akterë tjerë relevant (donatorë, universitete, qendra të trajnimeve, etj.).

- Aktivitetet për vajza dhe grupet minoritare.

KK-të janë përgjegjës të zhvillojnë kalendarin e aktiviteteve për vajza (p.sh. dita e vajzave, vajzat në TIK, mysafir folës nga gra të suksesshme në karrierë, etj.) dhe grupet minoritare (p.sh. dita e ndërmarrësisë për të fuqizuar vullnetin e tyre për shkollim dhe punësueshmëri) dhe t'i realizoj ato në bashkëpunim edhe me akterë tjerë relevant (p.sh. zyra komunale për minoritete, organizata rinore, etj.).

- Mirëmbajtja dhe përdorimi i Sistemeve Digjitale, duke ndjekur udhëzimet administrative dhe rregulloret e tjera përkatëse të parashikuara nga MASHTI, Komuna dhe IAAP-të.

Dy sistemet e mëposhtme janë minimumi që KK-të duhet të përdorin:

- Sistemi për gjurmimin e të diplomuarve.

- Sistemi për matjen e kënaqshmërisë së klientëve.

- Zbatimi i aktiviteteve për nxënësit/vijuesit me nevoja të veçanta.

A.2. Nxënësit e ardhshëm

- KK-të duhet të organizojnë ngjarjen e Ditëve të Hapura për çdo vit shkollor për nxënësit e klasës së 9-të për t'i ndihmuar ata për një zgjedhje të informuar për karrierë. Ngjarja duhet të zgjasë minimum 4 ditë dhe të ndodhë në fillim të semestrit të dytë të çdo viti shkollor.
- KK-të organizojnë sesione informuese për nxënësit e klasave të 9-ta (p.sh. vizita në shkolla, punëtori, tryeza të rrumbullakëta, etj.) në koordinim me përgjegjësit për karrierë në shkollat e mesme të ulëta për të prezantuar dhe promovuar profilet e IAAP-së.
- Puna me nxënës që braktisin shkollën për informim dhe mbështetje për karrierë.

F. BASHKËPUNIMI ME KOMUNITETIN

- KK-të duhet të krijojnë partneritete me palë të ndryshme me interes për IAAP duke nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit apo marrëveshje të vullnetit të mirë.
- KK-të duhet të bashkëpunojnë së paku me partnerët e mëposhtëm:
 - Zyrat e punësimit
Ato mund të ftohen të marrin pjesë në punëtori të ndryshme për të prezentuar tema të tilla si të drejtat e punonjësve; çështjet ligjore, shëndetësore dhe të sigurisë, etj.; të shkëmbejnë informacione për tregun e punës dhe vendet e lira të punës, të marrin pjesë në ngjarje të karrierës dhe në takimet me bizneset, etj.
 - Komuna

Ato mund të ftohen të marrin pjesë në ngjarje të karrierës dhe në takimet me bizneset; ato mund të ndihmohen në organizimin e ngjarjeve të komunitetit lokal duke i promovuar ato në mesin e nxënësve apo duke ofruar vullnetarë, etj.

- Organizatat e biznesit në nivel lokal dhe qendror
Ato mund të ftohen të marrin pjesë në ngjarje të karrierës dhe sesione të ndryshme për të ofruar informacione për tregun e punës.
- OJQ-të, organizatat rinore – promovojnë iniciativa përkatëse që mund të jenë të dobishme për nxënësit e AAP-së.
- Prindërit dhe Këshillin e Prindërve - duke i ftuar ata në ngjarje të karrierës dhe aktivitete tjera të shkollës.
- Organizatat donatore – KK-të mund të marrin pjesë në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve ose iniciativave të financuara nga donatorët që i shtojnë vlerë shërbimeve të karrierës të ofruara nga KK-të në IAAP.
- Asistimi dhe mobilizimi i të rriturve për të hyrë në arsimin profesional – KK-të mund të ofrojnë informacion të përgjithshëm për karrierë komunitetit lokal për të ndihmuar të rriturit të përmirësojnë kualifikimet ose rikualifikimet e tyre.
- Pjesëmarrja në aktivitete të lidhura me zhvillim të politikave në fushën e karrierës, si grupe pune, konferenca, etj.
- Rrjetëzimi i KK-ve – shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira dhe bashkëpunimi për të zhvilluar shërbime, materiale dhe informacione të karrierës.

Standardi 3 – Angazhimi dhe funksionimi i Këshilltarëve për Karrierë në IAAP

Emërtimi	Angazhimi dhe funksionimi i Këshilltarëve për Karrierë në IAAP
Qëllimi	Përcaktimi i numrit dhe funksionit të KK-ve të angazhuar varësisht nga numri i nxënësve në IAAP.
Kërkesat	<p>Numri i Këshilltarëve për Karrierë</p> <p>Numri i KK-ve përcaktohet varësisht nga numri i nxënësve në IAAP, si që është specifikuar në kategoritë e mëposhtme.</p> <p>1. Në IAAP deri në 500 nxënës:</p> <ul style="list-style-type: none"> 1.1. Një KK me normë të plotë për bashkëpunim me nxënës dhe komunitetin, i cili kryen edhe detyrat e menaxherit për tërë shërbimet/aktivitetet që ofrohen. 1.2. KK mund të angazhohet për më shumë se një IAAP në të njëjtën komunë, por jo më shumë se 500 nxënës gjithsej. 1.3. Nëse pozita e KK-së nuk mbulohet me normë të plotë, atëherë me propozim të IAAP-së, DKA plotëson këtë normë të plotë me dy gjysmë norma. 1.4. Norma e plotë për KK është e njëjtë si e mësimdhënësve. <p>2. Në IAAP me 501 deri në 1000 nxënës:</p> <ul style="list-style-type: none"> 2.1. Dy KK me norma të plota për bashkëpunim me nxënës dhe komunitetin. Njëri prej KK-ve në koordinim me drejtorin e IAAP-së merr edhe detyrat e menaxherit për tërë shërbimet/aktivitetet që ofrohen. 2.2. KK-të mund të angazhohen për më shumë se një IAAP në të njëjtën komunë, por jo më shumë se 1000 nxënës gjithsej.

2.4. Nëse dy pozitat e KK-ve nuk mbulohen me norma të plota, atëherë me propozim të IAAP-së, DKA plotëson këto dy norma të plota me gjysmë norma.

2.5. Norma e plotë për KK është e njëjtë si e mësimdhënësve.

3. Në IAAP me mbi 1000 nxënës:

3.1. Dy KK me norma të plota për bashkëpunim me nxënës dhe komunitetin. Njëri prej KK-ve në koordinim me drejtorin e IAAP-së merr edhe detyrat e menaxherit për tërë shërbimet/aktivitetet që ofrohen.

3.4. KK-të i shërbejnë vetëm një IAAP.

3.4. Nëse dy pozitat e KK-ve nuk mbulohen me norma të plota, atëherë me propozim të IAAP-së, DKA plotëson këto dy norma të plota me gjysmë norma.

3.5. Norma e plotë për KK është e njëjtë si e mësimdhënësve.

Funksioni i Këshilltarëve për Karrierë:

KK-të janë personel mësimdhënës që funksionojnë në kuadër të IAAP-së.

Në rast të mungesës së mësimdhënësve mbrenda IAAP-së, DKA me vendim të posaçëm emëron mësimdhënës nga institucionet tjera arsimore të komunës së njëjtë.

KK-të janë pjesë e skemës organizative të IAAP-së në kuadër të Këshillit Profesional sipas UA për menaxhimin e brendshëm të shkollave.

KK-të me propozim të IAAP-së për zgjidhen nga DKA, respektivisht AAAPARr, sipas përshkrimit të detyrave dhe kompetencave.

Shih Shtojcën 4 për informacion shtesë.

	<p>KK-të pajisen me kontratë nga DKA-të, respektivisht AAAPARr, me kohë të pacaktuar me normë të plotë, ose si mësimdhënës/KK në rastet me gjysmë norme.</p> <p>Kualifikimi dhe shkathtësitë e Këshilltarëve për Karrierë</p> <p>KK-të duhet të certifikohen me programin kualifikues për këshilltarët e karrierës të akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve në Kosovë.</p> <p>KK-të gjithashtu duhet të kenë aftësi të mira transversale.</p> <p><i>Shih <u>Shtojcën 4</u> për informacion shtesë.</i></p> <p>Raportimi i Këshilltarëve për Karrierë</p> <p>KK-të raportojnë sipas hierarkisë në skemën organizative të IAAP-së. Për punën e KK-ve, drejtori i IAAP-së raporton në DKA, respektivisht në AAAPARr.</p>
--	--

Standardi 4 - Hapësirat dhe pajisjet e nevojshme për punën e Këshilltarëve për Karrierë

Emërtimi	Hapësirat dhe pajisjet e nevojshme për punën e Këshilltarëve për Karrierë
Qëllimi	Përcaktimi i hapësirave dhe pajisjeve të punës të nevojshme për ofrimin cilësor të shërbimeve të karrierës.

<p>Kërkesat</p>	<p>Hapësirat e punës për Këshilltarët për Karrierë</p> <p>Hapësirat e punës duhet të jenë brenda IAAP-ve për të formuar një mjedis të këndshëm që stimulon funksionimin efektiv të punës së KK-ve. Kjo hapësirë përdoret edhe nga KMVP-të për koordinim të aktiviteteve të përbashkëta siç e përshkruan ky dokument në tërësinë e saj.</p> <p>Duhet të kenë sinjalistikë shumë të dukshme në mënyrë që të identifikohen lehtësisht nga vizitorët.</p> <p>Hapësirat dhe sipërfaqet e obligueshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Një zyrë me sipërfaqe 15-25m² • Një sallë trajnimi me kapacitet deri 25 nxënës me sipërfaqe 40-60 m². <p>Mobilieria e nevojshme për hapësirat e punës dhe ofrimin cilësor të shërbimeve.</p> <p>Pajisjet teknologjike</p> <p>Laptop për secilin KK.</p> <p>1 printer multifunksionale (printer, fotokopje, skaner).</p> <p>1 PC që mund të përdoret për të instaluar sistemet digjitale të punës dhe për t'u përdorur si databazë.</p> <p>1 projektor me ekranin e varur apo lëvizës.</p> <p>Lidhja me rrjetin dhe internetin</p> <p>Internet me kabëll apo wireless..</p>
------------------------	---

Standardi 5 - Monitorimi dhe vlerësimi i Këshilltarëve për Karrierë

Emërtimi	Monitorimi dhe vlerësimi i Këshilltarëve për Karrierë
Qëllimi	Përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për monitorim dhe vlerësim të këshilltarëve për karrierë në përmbushjen e objektivave dhe rezultateve.
Kërkesat	<p>Vlerësimi i objektivave strategjike</p> <p>Bëhet çdo 3 vjet.</p> <p>Bëhet nga drejtori i IAAP-së në bashkëpunim me KK-të dhe raporton në DKA/AAAPARr, dhe sipas kërkesës edhe në MASHTI.</p> <p>Vlerësimi i objektivave operacionale</p> <p>KK-të hartojnë planin vjetor të punës për IAAP-të përkatëse më së voni në gusht për vitin shkollor që fillon.</p> <p>Raportin e progresit të planit vjetor të punës e harton KK/menaxheri.</p> <p>Vlerësimi i raportit të progresit bëhet nga drejtori i IAAP-së.</p> <p>Vlerësimi i progresit të Planit Vjetor të Punës bëhet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në vitin e parë të angazhimit të KK-ve, dy herë në vit, pas semestrit të parë dhe pas semestrit të dytë të vitit shkollor. • Pas vitit të parë, një herë në vit pas përfundimit të vitit shkollor. <p>Vlerësimi i rezultateve</p> <p>KK-të planifikojnë rezultatet e pritshme bazuar në Planin Vjetor të Punës.</p> <p>Monitorimi i rezultateve bëhet vazhdimisht nga KK-të sipas treguesve të mëposhtëm:</p>

- Numri i punëtorive/sesioneve informuese/trajnimeve të organizuara sipas temave.
- Numri i nxënësve të përfshirë në punëtori/sesione informuese/trajnime sipas klasave dhe të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.
- Numri i nxënësve të mbështetur për punësim sipas klasave dhe të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.
- Numri i nxënësve të përgatitur me shkathtësitë e buta për realizim të suksesshëm të MVP-së.
- Numri i ngjarjeve të organizuara.
- Numri i nxënësve që ndoqën ngjarjet sipas klasave dhe të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.
- Numri i bizneseve unike⁸ që bashkëpunojnë me KK-të.

Raportin mbi rezultatet e arritura e harton KK/menaxheri dhe e vlerëson drejtori i IAAP-së si në vijim:

- Në vitin e parë të angazhimit të KK-ve, dy herë në vit, pas semestrit të parë dhe pas semestrit të dytë të vitit shkollor.
- Pas vitit të parë të angazhimit të KK-ve, një herë në vit pas përfundimit të vitit shkollor.

Sigurimi i cilësisë

KK-të përdorin sistemin e brendshëm të monitorimit të kënaqshmërisë së klientëve me shërbimet e ofruara dhe aktivitetet e realizuara, për:

- Nxënësit e AAP-së
- Nxënësit e ardhshëm
- Bizneset
- Anëtarët e komunitetit

⁸ Numri i bizneseve unike nënkupton bizneset që regjistrohen në databazë njëherë, dhe jo sa herë të angazhohen në aktivitete të ndryshme

	<p>KK-të përdorin sistemin e gjurmimit të të diplomuarve për çdo të diplomuar.</p>
--	--

9. SHTOJCAT për IAAP

Shtojca 1. Edukimi për karrierë

KK-të duhet t'i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësitë që nevojiten për të vlerësuar shtigjet e mundshme të karrierës. Temat për edukimin për karrierë për klasat 10, 11 dhe 12 dhe numri i orëve për semestër janë dhënë më poshtë:

Klasa 10 – 2 orë për semestër

Temat:

- Vlerësimi i shkathtësive dhe njohurive personale lidhur me karrierën e ardhshme të nxënësve

Rezultatet e të nxënit:

- Nxënësi tregon për qëllimet dhe planifikimet e karrierës “se çfarë janë të aftë të bëjnë”.
- Nxënësi shpjegon se si mund të arrijë qëllimet për të zhvilluar karrierën.
- Nxënësi përdor pajisjet teknologjike për të bërë hulumtimin e mundësive për orientim në karrierë.
- Nxënësi zhvillon dhe përditëson portfolion personale.

Klasa 11 – 3 orë për semestër

Temat:

- Ndërlidhja e njohurive dhe shkathtësive personale me nevojat e tregut të punës.

Rezultatet e të nxënit:

- Nxënësi mëson mbi etikën dhe sjelljen profesionale.
- Nxënësi mëson mbi ligjin e punës.
- Nxënësi mëson mbi aplikacionet e ndryshme për ndërtimin e CV-së dhe letrës motivuese.

Klasa 12 - 3 orë për semestër

Temat:

- Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë.
- Këshillimi dhe orientimi në karrierë.
- Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme.

- Komunikimi në / për jetë dhe punë.

Rezultatet e të nxënit:

- Nxënësi vlerëson aftësitë personale dhe profesionale si dhe arritjet e identifikuara në bazë të fushave të ndryshme të interesit sipas objektivave të caktuara për vetëpërmirësim, duke marrë në konsideratë ndikimet në zgjedhjen e karrierës në të ardhmen.
- Nxënësi aplikon forma të testimit përmes platformave të ndryshme për të vlerësuar aftësitë personale e profesionale.
- Nxënësi prezenton plane afatshkurtra dhe afatgjata, përmes vendimmarrjes për karrierë të mëtutjeshme.
- Nxënësi harton planin e zhvillimit personal për realizimin e qëllimeve të veta profesionale.
- Nxënësi përdor aplikacione softuerike për përpunimin e të dhënave për aktivitete të ndryshme profesionale.
- Nxënësi mëson të promovojë shkathtësitë personale përmes përgatitjes dhe prezentimit të projekteve.
- Nxënësi praktikon plotësimin online të aplikacioneve të ndryshme (për fakultet, bursa, projekte).
- Nxënësi praktikon aplikacione të ndryshme për ndërtimin e CV dhe letrës motivuese, si dhe praktikon mënyrat e dërgimit online të këtyre dokumenteve.
- Nxënësi aplikon burime të ndryshme të informimit për zhvillim personal dhe profesional

Shtojca 2. Informacionet dhe burimet për karrierën

Këshilltarët për Karrierë informojnë nxënësit për mundësitë për punësim brenda dhe jashtë vendit, mundësitë e trajnimit dhe mobilitetit, bursat dhe programet universitare, shërbimet vullnetare, ngjarje dhe informacione të tjera që lidhen me zhvillimin e karrierës.

Këshilltarët për Karrierë planifikojnë aktivitetet vjetore lidhur me ofrimin e informacioneve për karrierën, duke përfshirë punëtoritë, sesionet informuese, panairët e karrierës, prezentimet e punëdhënësve ose ngjarje të tjera.

Këshilltarët për Karrierë ofrojnë materiale informuese të printuara apo elektronike sipas nevojës.

Shtojca 3. Ngritja e shkathtësive të buta për karrierë dhe punësueshmëri

KK-të duhet të ofrojnë trajnime grupore për nxënësit, si dhe konsultime individuale sipas nevojës, për ngritjen e shkathtësive për zhvillim dhe menaxhim të karrierës dhe punësueshmërisë.

Ky program trajnimi komplimenton temat e zhvilluara në kuadër të Edukimit për Karrierë.

Prioritetet duhet t'u jepet klasave 12-ta për t'i përgatitur ato për qasje në tregun e punës dhe punësueshmëri.

Temat e trajnimit :

- Përgatitja e CV-së dhe letrës motivuese.
- Përgatitja për intervistë të punës.
- Hulumtimi për vende të punës dhe rishikimi i një oferte për punësim.
- Hulumtimi i programeve universitare dhe programeve trajnuese për arsim dhe aftësim të mëtutjeshëm dhe përgatitja për aplikim.
- Përgatitja me shkathësitë e buta për realizim të suksesshëm të MVP-së.
- Aktivitete tjera të lidhura me karrierën përfshirë mobilitetin e nxënësve, punën vullnetare dhe trajnime ekstra kurrikulare.

Shtojca 4: Përshkrimi i detyrave të Këshilltarëve për Karrierë

Kushtet e përgjithshme

- KK-të raportojnë sipas hierarkisë në skemën organizative të IAAP-së.
- KK-të janë mësimdhënës të IAAP-së të certifikuar me programin kualifikues për këshilltarë të karrierës të akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve në Kosovë.
- Norma për pozitën e KK-ve është e njëjtë si e mësimdhënësve në arsimin e mesëm të lartë.

Detyrat kryesore

Shërbimet për nxënësit/vijuesit e AAP-së

- Sipas standardit 2, pika A.1

Shërbimet për nxënësit e ardhshëm

- Sipas standardit 2, pika A.2.

Shërbimet për komunitetin

- Sipas standardit 2, pika B.

Punët administrative

- Zhvillimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për nxënësit, akterë nga komuniteti dhe palë tjera të interesit.
- Mirëmbajtja dhe përditësimi i kanaleve mediale sociale lidhur me aktivitetet e zhvilluara
- Mbajtja e evidencës mbi aktivitetet e zhvilluara dhe ndihmon në hartimin e raporteve të progresit.
- Mbikëqyrë nxënësit vullnetarë që ndihmojnë KK-të.
- Mbajtja e shënimeve të sakta për aktivitetet dhe rezultatet (monitorimi dhe vlerësimi);

Marketingu dhe promocioni

- Promovimi i shërbimeve të karrierës për grupe të ndryshme të synuara nëpërmjet ngjarjeve të ndryshme, publikimeve, aktiviteteve online, etj.
- Promovimi i shërbimeve të karrierës përmes mediave sociale dhe mediave nacionale.
- Zhvillimi i publikimeve dhe materialeve promovuese.

Menaxhimi (në rastet kur Këshilltarët për Karrierë kanë edhe përgjegjësinë e menaxhimit të shërbimeve/aktiviteteve)

- Koordinon dhe mbikëqyrë aktivitetet e KK-ve.
- Përgjigjet në çështjet komplekse lidhur me shërbimet e KK-ve (p.sh. dilemat mbi prioritetin e aktiviteteve).
- Menaxhon koordinimin me institucionet publike, autoritetet lokale dhe qendrore, donatorët etj.
- Merret me zhvillimin profesional të KK-ve (trajnimet dhe objektivat mësimore).
- Menaxhon aspektet financiare të aktiviteteve të KK-ve.
- Përgatitja e raporteve të progresit.

Aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme

- Aftësi për vendimmarrje
- Aftësi për planifikim
- Shkathtësi komunikuese dhe prezentuese
- Aftësi për menaxhimin e kohës
- Aftësi për punë në ekip
- Shkathtësi për zhvillim dhe mbajtje të trajnimeve
- Aftësi për rrjetëzim
- Aftësi për negocim
- Shkathtësi digjitale
- Aftësi në gjuhë të huaja (e preferuar).



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Ministarstva za Obrazovanje
Nauku, Tehnologiju i Inovacia-Ministry of Education Science, Technology and Innovation*

Standards for the organization and functioning of Career Counsellors in Upper Secondary School Institutions (USS) - Gymnasiums

June 2023



Table of contents

<u>1. INTRODUCTION</u>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
<u>2. CAREER COUNSELLING IN GYMANSIUMS</u>	5
<u>3. STANDARDS OF ORGANIZATION AND FUNCTIONING OF CAREER COUNSELLORS IN GYMNASIUMS</u>	6
<u>Standard 1 – Mission and objectives</u>	6
<u>Standard 2 – Role of Career Counsellors</u>	8
<u>Standard 3 – Recruitment and Functioning of Career Counsellors in Gymnasiums</u>	12
<u>Standard 4 – Required premises and equipment for the work of Career Counsellors</u>	15
<u>Standard 5 – Monitoring and Assessment of Career Counsellors</u>	16
<u>4. APPENDICES</u>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
<u>Appendix 1. Career education</u>	1
<u>Appendix 2. Career information and resources</u>	3
<u>Appendix 3. Soft skills development for career and employability</u>	3
<u>Appendix 4: Description of duties of Career Counsellors, Initial information about human resources</u>	6

Abbreviations

AVETAE	Agency for Vocational Education and Training and Adult Education
VET	Vocational Education and Training
NQA	National Qualification Authority
EARK	Employment Agency of the Republic of Kosovo
EU	European Union
CEDEFOP	European Centre for the Development of Vocational Training
MED	Municipal Education Directorate
EYE	Enhancing Youth Employment
IAEVG	International Association for Education and Vocational Guidance
PUI	Pre-University Institutions
VETI	Vocational Education and Training Institutions
MESTI	Ministry of Education, Science, Technology and Innovation
MFPT	Ministry of Finance, Labour and Transfers
OJL	On-the-Job Learning
KSEP	Kosovo Strategic Education Plan
VTC	Vocational Training Centre
CoC	Competency Centre
CC	Career Counsellors
EQF	European Qualification Framework

NQF	National Qualification Framework
USS	Upper Secondary Schools
LSS	Lower Secondary School

10.INTRODUCTION

